

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5857
E mërkurë, 21 gusht 2019
çmimi 0.40 €

'Presidenti' i Kosovës, Isa Mustafa, fillon konsultimet për qeverinë e re!

FAQE 8

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

MUHABI AZEMI, NJË VULLKAN I HESHTUR SHQIPTAR F. 11

Ismet Rashiti

AKTUALE

KOSOVA DHE MAQEDONIA PËRPIQEN TË GJEJNË ZGJIDHJE PËR BARRIERAT TREGTARE F. 7

VESELI SËRISH NË QKUK: PACIENTËT DËSHMOJNË VETË PËR NDRYSHIMET NË SHËNDETËSI F. 7

HARADINAJ: NDRYSHIMI I KUFIJVE, SKENAR MONSTRUOZ QË I SHËRBEN AGJENDËS RUSE F. 5

EKONOMI

SOT GREVË GJASHTËORËSHE NË AEROPORTIN "ADEM JASHARI" F. 9

PËRFAQËSUESIT E OEAQ-UT PREZANTOJNË PROPOZIMET E TYRE PËR QEVERINË E RE F. 9



SPORT

ZABERGJA: DO TË SHËNOJ SHUMË GOLA F. 16

FLET PËR "EPOKËN E RE", IBRAHIM GASHI

Qeveria e re duhet ta përshpejtojë agjendën e integritimeve

- Zgjedhjet duhet të sjellin qeveri që do ta përshpejtojë agjendën e integritimeve



Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Ibrahim Gashi, ka vlerësuar se zgjedhjet e parakohshme mund të ndikojnë në ngadalësimin e proceseve integruese. Por, ai ka thënë se qeveria e re duhet ta përshpejtojë agjendën e integritimeve evropiane të

Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Gashi ka deklaruar se institucionet e reja duhet të fokusohen në proceset euroatlantike, në dialogun me Serbinë si dhe në forcimin e shtetit ligjor duke shtuar luftën kundër

krimit dhe korrupsionit. Ai ka theksuar se agjenda e dialogut do të riaktualizohet menjëherë pas zgjedhjeve edhe nëse në krye të qeverisë do të jenë ata që e kanë kundërshtuar dialogun duke përdorur mjete të paligjshme për ta penguar këtë proces

Koalicioni AAK-PSD mund të nxisë koalicione të reja

Zyrtarizimi i koalicionit të parë parazgjedhor në mes të Aleancës për



Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Partisë Socialdemokrate (PSD) pritet ta nxisë lidhjen e koalicioneve të reja para datës së zgjedhjeve. Njohësit e rrethanave politike kanë paralajmëruar se ky koalicion do të pasohet me lëvizje të tjera politike. Deputeti i Kuvendit të Kosovës, Ilir Deda, ka bërë me dije se koalicioni AAK-PSD ka qenë i pritur, duke shtuar se shumë shpejt do të ndodhë edhe koalicioni i Alternativës me Lëvizjen Vetëvendosje F. 3

Kosova dhe Maqedonia përpiqen të gjejnë zgjidhje për barrierat tregtare F. 7



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Merkeli: Evropa bashkohet vetëm me anëtarësimin e Ballkanit Perëndimor

BERLIN, 20 GUSHT - Kancelaria gjermane Angela Merkel tha se Evropa do të bashkohet kur të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor të anëtarësohen në BE. Vërejtjet e Merkelit përfaqësuan një rikthim të fortë të angazhimit të Berlinit për zgjerimin e BE-së, një ide që është jopopullore te disa qeveri në BE dhe shumë votues në Evropën Perëndimore.

Presidenti francez Emmanuel Macron ka qenë veçanërisht skeptik për zgjerimin vitet e fundit. Kancelarja tha se uniteti

evropian nuk do të ishte i plotë derisa i gjithë Ballkani Perëndimor të anëtarësohet në BE. "Nëse i shikoni në mënyrë gjeostrategjike dhe gjithashtu shikoni hartën, atëherë do të ketë vetëm një Evropë të bashkuar vërtet me shtetet e Ballkanit Perëndimor", u tha Merkel gazetarëve në qytetin hungarez Sopron.

Gjashtë shtete të Ballkanit Perëndimor nuk janë anëtare të BE-së. Serbia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe

Shqipëria janë vende kandidatë zyrtarë për anëtarësimin në BE, ndërsa Bosnjë e Hercegovina dhe Kosova klasifikohen si "kandidatët e mundshëm".

Si Serbia dhe Mali i Zi kanë qenë të angazhuar në bisedime të anëtarësimit për vite me radhë. Ministrat e BE-së vendosën në qershor të vonojnë një vendim nëse do të fillojnë bisedimet e anëtarësimit me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë deri të paktën në tetor, kryesisht për shkak të rezistencës nga Franca dhe Holanda.



Biden kryeson fushatën e demokratëve për Shtëpinë e Bardhë

Edhe pse, sipas anketave, ish-zëvendëspresidenti Joe Biden vazhdon të udhëheqë mes sfiduesve demokratë për zgjedhjet presidenciale të vitit 2020, shqetësimet për moshën e Bidenit dhe gafat e tij në fjalime i kanë bërë demokratët që të shtrojnë pikëpyetje nëse ai do të ishte kandidati më i mirë përballë presidentit Trump në zgjedhjet e vitit që vjen


WASHINGTON, 21 GUSHT - Anketat e opinionit publik tregojnë se ish-zëvendëspresidenti Joe Biden vazhdon të udhëheqë mes sfiduesve demokratë për zgjedhjet presidenciale të vitit 2020, por shqetësimet për moshën e Bidenit dhe gafat e tij në fjalime i kanë bërë demokratët që të shtrojnë pikëpyetje nëse ai do të ishte kandidati më i mirë përballë presidentit Trump në zgjedhjet e vitit që vjen.

Në Ajova, Biden synon ta përforcojë statusin e tij në krye të garës demokrate, duke vënë në shënjestër presidentin Trump. "Nëse i japim atij tetë vjet, dhe këtë e besoj nga thellësia e zemrës sime, ai përgjithmonë do ta ndryshojë karakterin dhe natyrën tonë. Prandaj duhet ta mposhtim Trumpin në vitin

2020", tha ai.

Bideni mbetet në krye të anketave kombëtare dhe të shteteve, por përballë me konkurrencë të fortë nga disa rivalë, përfshirë senatorin e Masaçusetsit, Elizabeth Warren. "2020 është shansi ynë. Ne mund ta bëjmë këtë qeveri të punojë për të gjithë Amerikën. Demokratë, le ta bëjmë këtë. Të punojmë shumë dhe të fitojmë", tha ai, ka njoftuar vova.

Pavarësisht se ai është 76 vjeç, Biden mbetet një politikan energjik. Por, gjithashtu, ai ka shkaktuar kritika me një seri gafash, përfshirë komentet mbi ndihmat për varfrit. "Fëmijët e varfër janë po aq të zgjuar dhe të talentuar sa fëmijët e bardhë, fëmijët e pasur, fëmijët afrikano-amerikanë, fëmijët aziatikë", tha ai.



Bideni është vënë shpesh në shënjestër nga njeriu me të cilin dëshiron të përballë në zgjedhje, presidenti Trump. "Joe është i mangët. Ky nuk është dikush që mund të keni si president. Por nëse merr miratimin e demokratëve, do të më bëhej qejfi", tha Trumpi.

Bideni ka marrë disa goditje në debatet e para por, gjithashtu, ka treguar aftësi përtëritëse, thotë analistja Vanessa Beasley

e Universitetit Vanderbilt.

"Ende ka prova të mira që demokratët mendojnë se ai është njeriu me shanset më të mira për ta mundur Trumpin. Shumë demokratë po tregojnë zemërbutësi sepse duan që ai ta ruajë statusin e emrit më të njohur dhe shansin më të madh për ta mposhtur Trumpin", tha ajo.

Votimet e para mes kampit demokrat do të zhvillohen në

muajin shkurt, çfarë do të thotë se ka kohë të mjaftueshme që rivalët të fitojnë epërsi, thotë Kyle Kondik nga Universiteti i Virxhinias. "Bideni po kryeson, ndërsa i afrohem shtatorit dhe tetorit dhe pas disa debateve të tjera ai do të provojë se është kryesuesi më i qëndrueshëm i garës. Por, gjithashtu, ekziston mundësia që një pjesë e mbështetësve të tij të kalojë te kandidatët e tjerë, dhe pastaj do të kemi një garë më të hapur", tha ajo.

Demokratët, po ashtu, mbeten të ndarë mbi atë nëse ata duhet të përqendrohen te Trumpi apo te reformat gjithëpërfshirëse ekonomike dhe sociale, thotë analisti Darrell West nga Instituti Brookings. "Pra, debati kryesor aktual mes demokratëve po bëhet mbi atë nëse ata duhet të kërkojnë ndryshime të vogla dhe në thelb kthimin e Amerikës në atë që ishte para Trumpit, apo nevojën për ndryshime më thelbësore", tha Westi.

Kjo dilemë do të shfaqet përsëri kur demokratët ta zhvillojnë debatin e tretë muajin që vjen në Hjuston.

Meta priti ambasadorin e ri të Gjermanisë

TIANË, 20 GUSHT - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, pranoi të martën Letrat Kredenciale nga ambasadori i ri i Republikës Federale të Gjermanisë, Peter Zingraf.

Presidenti Meta vlerësoi marrëdhëniet e shkëlqyera midis dy vendeve dhe shprehu mirënjohjen e thellë për mbështetjen 30-vjeçare të Gjermanisë për zhvillimin e Shqipërisë dhe integrimin e saj në strukturat euro-atlantike. "Shqipëria do të vijojë të mbështetet me besim dhe

bashkëpunim gjithnjë e më të ngushtë të Gjermania mike dhe partnere strategjike. Ne mirëpresim angazhimin e sinqertë dhe vendimtar të Bundestagut për ta ndihmuar Shqipërinë në rrugën drejt çeljes së negociatave të anëtarësimit me Bashkimin Evropian dhe për përparimin e vendit tonë drejt standardeve demokratike evropiane", tha Presidenti Meta. Gjithashtu, Meta shprehu mirënjohjen për vëmendjen e madhe që Gjermania u kushton

marrëdhënive me Shqipërinë si edhe zhvillimeve në rajon, duke vlerësuar vizionin e palëkundur të kancelares Angela Merkel për integrimin e Shqipërisë dhe të Ballkanit Perëndimor në BE. Duke i përcjellë presidentit Meta përshëndetjet e presidentit të Gjermanisë, Frank-Walter Steinmeier, ambasadori Zingraf u shpreh se ndihet mjaft i lumtur që fillon detyrën si ambasador i Gjermanisë në Shqipëri.



Njohësit e rrethanave politike kanë paralajmëruar koalicione të reja parazgjedhore

Koalicioni AAK-PSD mund të nxisë koalicione të reja

Zyrtarizimi i koalicionit të parë parazgjedhor në mes të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Partisë Socialdemokrate (PSD) pritet ta nxisë lidhjen e koalicioneve të reja para datës së zgjedhjeve. Njohësit e rrethanave politike kanë paralajmëruar se ky koalicion do të pasohet me lëvizje të tjera politike. Deputeti i Kuvendit të Kosovës, Ilir Deda, ka bërë me dije se koalicioni AAK-PSD ka qenë i pritur, duke shtuar se shumë shpejt do të ndodhë edhe koalicioni i Alternativës me Lëvizjen Vetëvendosje

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 20 GUSHT - Lidhja e koalicionit të parë parazgjedhor në mes të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Partisë Socialdemokrate (PSD) do të nxisë edhe lëvizje të tjera politike në ditët në vijim.

Deputeti i Kuvendit të Kosovës, Ilir Deda, ka bërë me dije se ky koalicion ka qenë i pritur, duke kritikuar ata që pamundësuan një listë zgjedhore opozitare. "Gjithçka që po ndodh sot në politikë e ka një kontekst nga e

kaluara. Në ditët dhe javët e ardhshme me gjasë do të ketë shumë lëvizje politike dhe do të përpiqem t'ua shpjegoj kontekstin e tyre sipas këndvështrimit tim. Deklaratat e LDK-së se pëlqen të shkojë e vetme në zgjedhje dhe ato të LV-së se vetëm Albini duhet të jetë kandidat për kryeministër, na humbën kohë dhe e prishën mundësinë e listës së përbashkët opozitare", ka shkruar Deda në profilin e vet në "Facebook". Sipas tij, shumë shpejt do të ndodhë edhe koalicioni parazgjedhor Alternativa me Lëvizjen Vetëvendosje. "Për të

gjithë ata që po 'çuditen' me koalicionin e Shpendit me Ramushin, po pres me e pa 'çudinë' e njëjtë të 'koalicionit' të Mimoza's me Albinin. Çdokush rrugës së vet", ka shkruar ai. Edhe të martën ka pasur lëvizje të reja politike dhe aderime të reja. Një ditë pas arritjes së koalicionit me PSD-në, lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka takuar kryetarin e Nismës, Fatmir Limaj, me të cilin ka biseduar rreth seancës për shpërndarjen e Kuvendit e cila do të mbahet të enjten. Pas takimit, Haradinaj ka deklaruar se kësaj radhe nuk

kanë diskutuar për ndonjë koalicion me këtë parti, ndonëse ka pranuar se ka disponim për një koalicion të tillë. "Jemi taku me z. Limaj, nuk ka pasur mundësi për të folur për koalicion me Nismën, por disponim ka. Nuk jemi pajtuar për ndonjë marrëveshje", ka thënë Haradinaj. Por, disponimi i Nismës tani për tani është që kjo parti të shkojë e vetme në zgjedhje të parakohshme. Shefi i grupit parlamentar i Nismës Socialdemokrate, Bilal Sherif, ka thënë se kjo parti aktualisht është në fazën e konsultimeve me strukturat e partisë. "Nisma Socialdemokrate është duke punuar që në zgjedhje të shkojë e vetme. Aktualisht jemi në fazën e konsultimeve me strukturat e partisë. Pas përfundimit të konsultimeve me strukturat tona, atëherë do të mund të dalim me një vendim përfundimtar. Unë personalisht kam vizituar shumicën e degëve në nivel vendi

dhe, sa kam parë, shumica e tyre kërkon që Nisma të garojë e vetme në këto zgjedhje. Megjithatë, vendimi përfundimtar iu takon strukturave drejtuese të partisë", ka thënë Sherifi. As Lëvizja Vetëvendosje nuk ka qëndruar duarkryq. Lideri i këtij subjekti politik, Albin Kurti, ka bërë me dije se të martën kësaj lëvizje i është bashkuar edhe analisti politik Haki Abazi. "Haki Abazi na u bashkua në Vetëvendosje. Njohuritë e gjera dhe përvoja zhvillimore e Hakiut në Kosovë dhe vende të ndryshme nëpër botë, e bëjnë atë një vlerë të shtuar në Lëvizjen tonë. Hakiu njihet, mes të tjerash, për përkrahjen e vazhdueshme për themelimin e dhjetëra organizatave në Kosovë që promovojnë filantropinë, zhvillimin e qëndrueshëm, idetë ndërmarrëse inovative, lirinë e mediave, luftën kundër korrupsionit dhe qeverisjen e përgjegjshme. Ai ka jetuar e punuar në 120 shtete të botës në 20 vjetet e fundit", ka shkruar Kurti, duke shtuar se Abazi do të ndikojë në fitoren e pashmangshme të LV-së në këto zgjedhje. "Me Hakiun në Lëvizje, ndryshimet e domosdoshme në shtetin tonë po bëhen edhe më të afërta dhe më të lehta. Do të ecim bashkë drejt zgjerimit të mëtutjeshëm dhe fitores së pashmangshme", ka shkruar Kurti. Ndërsa kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka njoftuar se të premten ka ftuar mbledhjen e dytë të Këshillit të Përgjithshëm të kësaj partie. Në njoftimin për medie të LDK-së nuk është treguar nëse në këtë mbledhje do të flitet rreth koalicioneve parazgjedhore. Sipas këtij njoftimi, në rend ditës do të jenë dy pika: rezultatet në zgjedhjet e fundit të përgjithshme dhe lokale dhe perceptimi publik për LDK-në si dhe zgjedhja e kryesisë së LDK-së. "Ky takim mbahet në selinë e këtij subjekti politik më 23 gusht nga ora 17:30", është thënë në njoftimin e LDK-së.



Prishtina, një prej kryeqyteteve shembuj për transparencë

PRISHTINË, 20 GUSHT (ER) - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka shpalosur të gjeturat e hulumtimit mbi transparencën e kryeqyteteve evropiane, ku ka dalë që Prishtina është një prej kryeqyteteve shembuj për transparencë. Hulumtimi tregon se kryeqytetet e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian u ofrojnë qytetarëve më shumë qasje në informacion, por që vendet e Evropës Lindore e

Juglindore i japin më shumë rëndësi transparencës sesa vendet me demokraci të konsoliduar. Në KDI u tha se kjo bëhet si tentativë për ta adresuar korrupsionin më të thellë përmes politikave transparente. Diana Metushi-Krasniqi nga KDI-ja, gjatë paraqitjes së raportit, në një konferencë për media ka thënë se janë matur 27 kryeqytete evropiane. Ajo ka bërë me dije se një

shqetësim është ngritur lidhur me regjistrin e lobimit, ku hulumtimi ka gjetur se shumë shtete, në mesin e tyre edhe Kosova, nuk kanë ligje të cilat e rregullojnë lobimin. Më tutje, ajo ka thënë se vetëm 12 nga 26 kryeqytetet e matura kanë kthyer përgjigje pozitive në kërkesën për qasje në dokumente publike lidhur me pagën e kryetarit dhe asamblistëve.



Flet për "Epokën e re", Ibrahim Gashi

Qeveria e re duhet ta përshpejtojë

- Zgjedhjet duhet të sjellin qeveri që do ta përshpejtojë agjendën e integrimeve



Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Ibrahim Gashi, ka vlerësuar se zgjedhjet e parakohshme mund të ndikojnë në ngadalësimin e proceseve integruese. Por, ai ka thënë se qeveria e re duhet ta përshpejtojë agjendën e integrimeve evropiane të Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Gashi ka deklaruar se institucionet e reja duhet të fokusohen në proceset euroatlantike, në dialogun me Serbinë si dhe në forcimin e shtetit ligjor duke e shtuar luftën kundër krimit dhe korrupsionit. Ai ka theksuar se agjenda e dialogut do të riaktualizohet menjëherë pas zgjedhjeve edhe nëse në krye të qeverisë do të jenë ata që e kanë kundërshtuar dialogun duke përdorur mjete të paligjshme për ta penguar këtë proces

EPOKA E RE**Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 20 GUSHT - Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Ibrahim Gashi, ka thënë të martën se zgjedhjet e parakohshme duhet të sjellin një qeveri që do ta përshpejtojë agjendën e integrimeve evropiane. Në këtë intervistë

dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se institucionet e reja duhet të fokusohen në proceset euroatlantike, në dialogun me Serbinë si dhe në forcimin e shtetit ligjor duke e shtuar luftën kundër krimit dhe korrupsionit. "Shpresoj të kemi zgjedhje të lira, me pjesëmarrje të madhe të masës elektorale dhe që nga ky

Pacolli priti në takim lamtumirës ambasadorën kroate Kapitanoviq

PRISHTINË, 20 GUSHT (ER) - Zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, ka pritur të martën në takim lamtumirës ambasadorën e Kroacisë, Marija Kapitanoviq. Ministri Pacolli ka falënderuar ambasadorën Kapitanoviq për punën e saj dhe për

mbështetjen e vazhdueshme të Kroacisë në të gjitha fushat. "Me projekte dhe investime konkrete, Kroacia ka ndihmuar Kosovën për forcimin e institucioneve, subjektivitetit ndërkombëtar dhe zhvillimin ekonomik", ka thënë ministri Pacolli. Ndërsa ambasadorja e Kroacisë, Marija Kapitanoviq,

ka theksuar se Kroacia edhe më tutje do ta vazhdojë përkrahjen për Kosovën, duke rritur shkëmbimin në të gjitha fushat. Në fund, ministri Pacolli ka falënderuar ambasadorën Kapitanoviq për kontributin për thellimin e marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve, duke i uruar suksese në pozitën e ardhshme.



Fitojë agjendën e integrimeve

seve ndërkombëtare të rëndësishme për Kosovën për një kohë ngadalësohet. Pra, agjenda evropiane për disa muaj i subordinohet prioritetit që ka procesi zgjedhor. Edhe pas zgjedhjeve deri te konstituimi i institucioneve të reja të dala nga zgjedhjet mund të marrë një kohë. Të shpresojmë, jo shumë të gjatë", është shprehur Gashi.

Ai ka theksuar se agjenda e dialogut do të riaktualizohet menjëherë pas zgjedhjeve edhe nëse në krye të qeverisë do të jenë ata që e kanë kundërshtuar dialogun duke përdorur mjete të paligjshme për ta penguar këtë proces. "Për këtë ka një insistim dhe angazhim të partnerëve tanë kryesorë ndërkombëtarë si nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA), po ashtu edhe nga vendet më të fuqishme të Bashkimit Evropian (BE). Thirrja e fundit e Quintit tregon se ky proces duhet të dinamizohet menjëherë pas konstituimit të institucioneve të reja të dala nga zgjedhjet. Kjo do të ndodhë kushdo që do ta udhëheqë qeverinë e ardhshme, madje edhe nëse në krye të ekzekutivit do të jenë partitë që për një kohë të gjatë janë deklaruar kundër dialogut dhe kanë përdorur mjete të paligjshme për ta penguar atë", ka thënë Gashi.

Në këtë intervistë Gashi ka folur edhe për zgjedhjet në Parlamentin Evropian, për të cilat ka thënë se, megjithatë, nuk e rrezikuan procesin e zgjerimit të BE-së. Sa i takon Kosovës, ai ka thënë se nuk mund të themi se kemi pozicion më të favorshëm. Sipas Gashit, Kosova mund ta fitojë statusin e kandidatit në Bashkimin Evropian nëse tregohet shumë më serioze në rrugën drejt reformave evropiane. "Mund të themi se forcimi i partive euroskeptike ishte më shumë simbolik sesa determinues. Sigurisht, sa i takon Kosovës, nuk mund të themi se kemi pozicion më të favorshëm.

Maksimumi çka mund të presim është që Kosova ta fitojë statusin e kandidatit në Bashkimin Evropian, natyrisht, nëse tregohet shumë më serioze në rrugën drejt reformave evropiane", ka theksuar Gashi.

"Epoka e re": Profesor, të enjten pritët të shpërndaht Kuvendi dhe më pas të ketë zgjedhje të parakohshme. Mbajtja e këtyre zgjedhjeve, a do të ketë ndikim në agjendën evropiane të Kosovës?

Gashi: Sigurisht se zgjedhjet krijojnë një periudhë kur dinamika sa iu takon proceseve ndërkombëtare të rëndësishme për Kosovën për një kohë ngadalësohet. Pra, agjenda evropiane për disa muaj i subordinohet prioritetit që ka procesi zgjedhor. Edhe pas zgjedhjeve deri te konstituimi i institucioneve të reja të dala nga zgjedhjet mund të marrë një kohë. Të shpresojmë, jo shumë të gjatë.

"Epoka e re": Mendoni se zgjedhjet do të ndikojnë negativisht në integrimin evropian, anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare, liberalizimin e vizave dhe procesin e dialogut?

Gashi: Nuk mund të thuhet se zgjedhjet ndikojnë keq në proceset e përmendura, por se për një periudhë ndikojnë në ngadalësimin e këtyre proceseve, kjo logjikisht do të ndodhë.

"Epoka e re": Prisni se pas këtyre zgjedhjeve dhe krijimit të institucioneve të reja të avancohet qasja e Kosovës ndaj këtyre proceseve?

Gashi: Unë shpresoj të kemi zgjedhje të lira, me pjesëmarrje të madhe të masës elektorale dhe nga ky proces të dalin sa më parë (brenda afateve ligjore) një parlament dhe qeveri e përgjegjshme, e cila do të përqendrohet në proceset e rëndësishme shtetndërtuese, si në procesin e liberalizimit të vizave, në procesin e integritit evropian dhe euroatlantik, në

procesin e vazhdimt të dialogut dhe, mbi të gjitha, në agjendën e brendshme të zhvillimit ekonomik dhe forcimit të shtetit ligjor, duke e shtuar luftën kundër krimit dhe korrupsionit.

"Epoka e re": Pavarësisht se Kosova është në prag të procesit zgjedhor, Quinti ka bërë thirrje për rifillimin e dialogut me Serbinë. Si e shihni ecurinë e këtij procesi?

Gashi: Agjenda e dialogut do të riaktualizohet menjëherë pas zgjedhjeve. Për këtë ka insistim dhe angazhim të partnerëve tanë kryesorë ndërkombëtarë si nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA), po ashtu edhe nga vendet më të fuqishme të Bashkimit Evropian (BE). Thirrja e fundit e Quintit tregon se ky proces duhet të dinamizohet menjëherë pas konstituimit të institucioneve të reja të dala nga zgjedhjet. Kjo mendoj do të ndodhë pavarësisht kush do ta udhëheqë qeverinë e ardhshme, madje edhe nëse në krye të ekzekutivit do të jenë partitë që për një kohë të gjatë janë deklaruar kundër dialogut dhe kanë përdorur mjete të paligjshme për ta penguar atë.

"Epoka e re": Z. Gashi, si e vlerësoni përbërjen e re në Parlamentin Evropian dhe a prisni të ketë ndryshim të pikëpamjes karshi Kosovës?

Gashi: Zgjedhjet e fundit për Parlamentin Evropian, sado që lëkundën pozicionet dominuese të partive tradicionale, ato nuk e rrezikuan procesin e zgjerimit të BE-së. Mund të themi se forcimi i partive euroskeptike ishte me shumë simbolik sesa determinues. Sigurisht sa i takon Kosovës nuk mund të themi se kemi pozicion më të favorshëm. Maksimumi çka mund të presim është që Kosova ta fitojë statusin e kandidatit në Bashkimin Evropian, natyrisht nëse tregohet shumë më serioze në rrugën e saj drejt reformave evropiane.

proces të dalin sa më parë (brenda afateve ligjore) një parlament dhe qeveri e përgjegjshme që të përqendrohet në proceset e rëndësishme shtetndërtuese, si në procesin e liberalizimit të vizave, të integritit evropian dhe euroatlantik, në procesin e vazhdimt të dialogut dhe, mbi të gjitha, në agjendën e brend-

shme të zhvillimit ekonomik dhe forcimin e shtetit ligjor, duke e shtuar luftën kundër krimit dhe korrupsionit", ka deklaruar Gashi. Sipas tij, zgjedhjet e parakohshme mund të ndikojnë në ngadalësimin e proceseve integruese. "Sigurisht se zgjedhjet krijojnë një periudhë kur dinamika sa iu takon procese-

Haradinaj: Ndryshimi i kufijve, skenar monstruoz që i shërben agjendës ruse

PRISHTINË, 20 GUSHT (ER) - Kryeministri në dorëheqje, Ramush Haradinaj, ka pritur të martën në takim lamtumirës ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Ruairi O'Connell. Ai ka falënderuar ambasadorin O'Connell për bashkëpunimin e shkëlqyer dhe të hapur për këto vite shërbimi

në Kosovë, duke ndihmuar dhe ballafaquar Kosovën me të gjitha temat që rëndojnë rrugën tonë përpara synimit euroatlantik. Me këtë rast, Haradinaj ka shprehur besimin se Britania do të jetë kundër ndryshimit të kufijve që, sipas tij, është skenar monstruoz që i shërben agjendës ruse. "Unë besoj se

Mbretëria e Bashkuar do të vazhdojë të jetë kundër çfarëdo ndryshimi territorial apo të kufijve në Ballkan dhe do të mbetet përherë adresë e sigurt për popullin e Kosovës, se një skenar i tillë monstruoz që i shërben agjendës së Rusisë në Kosovë, nuk do të realizohet asnjëherë", ka thënë Haradinaj.



Nënshkruhet marrëveshja për ofrimin e shërbimeve të specializuara

PRISHTINË, 20 GUSHT (ER) - Nën kryetari i Komunës së Prishtinës, Muhedin Nushi, ka nënshkruar një marrëveshje bashkëfinansimi me organiza-

tën "Terre des hommes - Kosovo" për ofrimin e shërbimeve të specializuara. Kjo marrëveshje është nënshkruar në kuadër të projektit "Rrjeti i

Mbrojtjes së Fëmijëve - Faza 3" për shërbime të specializuara për fëmijë në gjendje rruge, për shërbimet e urgjencës për fëmijët të cilët gjenden në

rrethikshmëri të lartë dhe kanë nevojë për strehim të menjëhershëm si dhe për shërbime të specializuara për fëmijë viktime të abuzimit seksual.



Gjilani fillon programin e financuar nga qeveria britanike për 'Shkollat e shekullit 21'

GJILAN, 20 GUSHT (ER) - Në Komunën e Gjilanit është mbajtur takim i përbashkët i Drejtorisë Komunale të Arsimit me përfaqësuesit e programit "British Council" dhe drejtorët e shkollave për ta filluar zbatimin e programit për "Shkollat e shekullit 21", që parasheh zhvillimin e mendimit kritik, zgjidhjen e problemeve dhe kodimin në programe të ndryshme kompjuterike.

Në fjalën e tij, drejtori i Arsimit në Gjilan, Nazim Gagica, bashkë me koordinatoren e programit

"Shkollat e shekullit 21" të "British Council", Edona Begu, në takim me drejtorët kanë thënë se ky është parapërgatitje për ta filluar zbatimin e projektit "Shkollat e shekullit 21". "Është program edukativ ambicioz i dizajnuar nga 'British Council', i financuar nga Qeveria e Britanisë, i cili do të finalizohet brenda tre vjetëve. Ky program u ofron nxënësve të Komunës së Gjilanit shkathtësi në mendim kritik, zgjidhje të problemeve dhe kodim si dhe nxënësit do të kenë mundësinë t'i praktikojnë

shkathtësitë në programin kompjuterik", është thënë në njoftimin e Komunës së Gjilanit. Në kuadër të këtij programi shkollat e Komunës së Gjilanit do të pajisen me 790 microbit - kompjuterë të xhepit me anë të të cilëve nxënësit do të mund të programojnë në lëndë të ndryshme mësimore që t'i zgjidhin problemet e përditshme. Pjesë e programit në fjalë do të jenë edhe 123 mësimdhënës dhe të gjithë drejtorët e shkollave të Komunës së Gjilanit.



Drejtuesit e Malishevës dhe GIZ-it diskutojnë për hartën zonale



MALISHEVË, 20 GUSHT (ER) - Nën kryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, i shoqëruar nga shefi i Drejtorisë së Urbanizimit, Ahmet Morina, dhe zyrtarë të këtij departamenti, kanë pritur në takim përfaqësuesit e GIZ-it të drejtuar nga Michael Leader, me të cilin kanë diskutuar për projektin e hartës zonale në Komunën e Malishevës. Berisha ka thënë se ky projekt ka rëndësi ekonomike dhe mjedisore për Malishevën. "Rëndësinë e këtij projekti që ka për zhvillimin ekonomik, mbrojt-

jen e mjedisit në tërë territorin e komunës, mbrojtjen e tokave bujqësore, njëkohësisht tha se të gjitha vendimet komuna i merr të bazuara në planin zhvillimor komunal, të cilin e ka të miratuar këtë vit, si dhe shprehi gatishmërinë për bashkëpunim të plotë në këtë drejtim mes ekipit të urbanizimit dhe përfaqësuesve të GIZ-it, që t'i përmbushin objektivat dhe një hap e më parë edhe Malisheva të bëhet me hartë zonale", ka thënë Berisha. Kurse përfaqësuesi i GIZ-it, Michael Leader, ka thënë se

vendimi për këtë projekt pritet të merret brenda disa muajve. "Për këtë projekt puna në hartim ka filluar tash e dy vjet dhe është bërë një punë e madhe duke identifikuar shumë nevoja që kanë dalë gjatë punës dhe tash jemi në fazën e dytë, por vendimi pritet të merret disa muaj më vonë, brenda vitit dhe ende nuk dihet se cilat komuna do të mbështeten", është shprehur Leader.

Ekipi i urbanizimit ka bashkëpunuar edhe me ekipet e komunave fqinje për këtë projekt.

Deçani bëhet gati për fillimin e vitit të ri shkollor

DEÇAN, 20 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, së bashku me drejtorin e Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA), Bekim Vishaj, dhe bashkëpunëtorë të tjerë, kanë takuar të martën të gjithë drejtorët e shkollave të kësaj komune. Në këtë takim është diskutuar lidhur me përgatitjet për vitin e ri shkollor 2019/2020, i

cili do të nisë më 2 shtator. Nga drejtorët e shkollave, kryetari Ramosaj është njoftuar lidhur me përgatitjet që janë bërë për këtë fillimvit, për furnizimin me lëndë djegëse që ka filluar dhe është duke vazhduar për t'u përmbyllur së shpejti në të gjitha shkollat. Ndonëse në këtë takim është bërë me dije se do të nisë ndërtimi i dy shkollave

të reja, po ashtu është folur edhe për renovimin e atyre ekzistuese dhe për inventarizimin e disa shkollave, në mënyrë që të krijohet ambient i përshtatshëm për nxënës dhe mësimdhënës. Ramosaj ka kërkuar nga drejtorët të jenë edhe më të përkushtuar së bashku me mësimdhënësit që ta rrisin cilësinë mësimore në të gjitha shkollat.



Komuna e Drenasit përfiton 500 shporta për mbeturina të riciklueshme



DRENAS, 20 GUSHT (ER) - Në kuadër të reformave për menaxhimin e mbeturinave dhe bashkëpunimin disaveçar në mes të Komunës së Drenasit, përkatësisht Drejtorisë së Shërbimeve

Publike dhe Emergjencë, GIZ-it gjerman si dhe organizatës GAC, të martën ndërmarrja regjionale "Pastrimi" ka pranuar një kontingjent prej 500 shportave të cilat kanë për qëllim ndarjen e mbeturinave

të riciklueshme në burim. Me këtë rast, drejtoresha e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, Lumnije Krapa, ka falënderuar organizatën GIZ dhe GAC për bashkëpunimin e vazhdueshëm për të pasur një

mjedis sa më të pastër. Shportat 240L do të shpërndahen në ekonomi familjare dhe biznese dhe kanë për qëllim ruajtjen e mjedisit dhe zvogëlimin e sasisë së mbeturinave në deponi.

Kosova dhe Maqedonia përpiqen të gjejnë zgjidhje për barrierat tregtare

Zyrtarë të Qeverisë së Kosovës dhe ata të Qeverisë së Maqedonisë së Veriut janë pajtuar që deri në fund të kësaj jave t'i heqin barrierat në mes këtyre dy shteteve për disa produkte. Ministri në largim i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, është takuar me ministrin maqedonas të Ekonomisë për të diskutuar për gjetjen e një zgjidhjeje për barrierat tregtare në mes të dy vendeve

**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 20 GUSHT - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka pritur të martën në takim ministrin e Ekonomisë të Maqedonisë Veriore, Kreshnik Bekteshin, me të cilin kanë diskutuar për zgjidhjen e barrierave tregtare në mes të dy vendeve. Ministri Shala ka theksuar se janë pajtuar të gjejnë një zgjidhje për largimin e barrierave. "Diskutuam mbi disa probleme që kohët e fundit disa biznese tona i kanë hasur gjatë të bërit tregti në Maqedoninë e Veriut. Ne si Qeveri e Kosovës, Ministri e Tregtisë dhe Industrisë dhe Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë jemi pajtuar sot që t'i dërgojmë garanci shtesë Maqedonisë së Veriut, e këto garanci Kosova nuk e ka obligim

t'i ketë me vendet e tjera nënshkruese të CEFTA-s. Agjencia jonë e Veterinës deri të premtën do të sigurojë atë të Maqedonisë së Veriut për programin e monitorimit aktiv me qëllim që AUVK në Maqedoni ta ketë më të lehtë që pastaj atë produkt ta tregtojë në BE. AUVK në Maqedoni gjatë kësaj jave pritet ta heqë barrierën ndaj Kosovës, por në momentin kur të dyja palët i përfundojnë këto atëherë do ta eliminojnë masën e vendosur nga ne si MTT", ka thënë Shala.

Ai ka bërë me dije se ka kërkuar nga pala e Maqedonisë së Veriut të kenë marrëdhënie tregtare pa barriera. "Jemi të interesuar për ta tejkaluar situatën dhe urojmë që mos të përsëritet. Kemi vullnet të kemi marrëdhënie tregtare pa barriera, me të gjithë, sepse jemi partnerë në rrugën tonë drejt Bashkimit Evropian, por duke



respektuar njëri-tjetrin. Ka ardhur koha që të tjerët të na besojnë në punën dhe kontrollin tonë, aq sa edhe ne u besojmë atyre", ka thënë Shala.

Ndërsa ministri i Ekonomisë së

Maqedonisë së Veriut, Kreshnik Bekteshi, ka thënë se janë të interesuar ta gjejnë një zgjidhje dhe t'i vazhdojnë raportet tregtare me Republikën e Kosovës. "Bashkëpunimi në mes

të dyja palëve është në interes të thellimit dhe bashkëpunimit të mëtejshëm. Ne e mbështesim Kosovën në të gjitha instancat ndërkombëtare", ka deklaruar Bekteshi.

Veseli sërish në QKUK: Pacientët dëshmojnë vetë për ndryshimet në shëndetësi



**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 20 GUSHT - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka vazhduar vizitat dhe takimet me punëtorët shëndetësorë. Ai ka qëndruar të martën në hapësirat e modernizuara të Kardiokirurgjisë duke thënë se ky është shembulli i luftës kundër korrupsionit. Megjithatë, sipas tij, lufta kundër korrupsionit nuk mund të fitohet në një ditë, por dëshmon se suksesi do të bëjë të mundur të ndërtohet një e ardhme më e mirë. "Sot takova shumë punëtorë shëndetësorë në QKUK, e cila është model i luftës

kundër korrupsionit dhe dëshmi e reformës së madhe në shëndetësi. Tash kemi shërbime më të shpejta, më efikase dhe më cilësore, me pajisje shumë moderne. Milionat e kursyera nga lufta kundër korrupsionit në shëndetësi i kemi investuar në infrastrukturë, në blerje të pajisjeve të reja dhe në shërbime 24 orë. Shembulli i sektorit të shëndetësisë dëshmon se lufta kundër korrupsionit nuk është vetëm e drejtë, por ajo sjell edhe përfitime të vazhdueshme. Lufta kundër korrupsionit nuk fitohet për një ditë, por me shëndetësinë mund të dëshmojmë se suksesi në këtë luftë na mundëson që të ndërtojmë një të ardhme më të mirë", ka thënë Veseli.

Ai ka shtuar se askush më mirë se pacientët nuk i vërejnë ndryshimet në shëndetësi. "Po ashtu, sot takova disa prej pacientëve që kanë marrë shërbime mjekësore në Klinikën e Kardiologjisë, pas reformës radikale të bërë aty. Ata më treguan se kanë marrë shërbime publike cilësore dhe të shpejta, pa pasur nevojë që të shpenzojnë para në sektorin privat. Edhe pacientët e shtruar më treguan se janë të kënaqur me kujdesin që po marrin nga personeli mjekësor. Ne e bëmë betejën që askush nuk kishte guxim ta bënte. Lufta kundër korrupsionit është e vështirë, por me vendosmërinë dhe vullnetin e duhur do t'ia dalim", ka deklaruar Veseli.

Përurohet parkingu i ri në QKUK

PRISHTINË, 20 GUSHT (ER) - Në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës është bërë përurimi i parkingut të ri i cili do t'i ketë rreth 400 vendparkingje. Parkingu i ri është i shtrirë në pjesën jugore të oborrit të QKUK-së, pas Klinikës së Ortopedisë dhe ka synim t'i

lirojë trotuarët e t'i eliminojë tollovitë e krijuara tash e disa vjet. Drejtori i ShSKUK-së, dr. Basri Sejdiu, ka vlerësuar se krijimi i hapësirave të reja do të ofrojë vende më të përshtatshme dhe më shumë siguri për veturat. Si rezultat i menaxhimit

efikas, te hyrat nga laurat (hyrjet) në QKUK janë rritur për 400 për qind, duke i dhënë mundësinë për më shumë investime në infrastrukturë, me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për pacientët dhe stafin shëndetësor.



'Presidenti' i Kosovës, Isa Mustafa, fillon konsultimet për qeverinë e re!



Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA

A ka mend në këtë vend: Pasi thuaja të gjitha partitë politike në Kosovë u pajtuan, me qyqë të zorit, për zgjedhje të jashtëzakonshme, u caktua data dhe dita për shpërbërje të Kuvendit të Kosovës, më 22 gusht 2019. Ata që janë më pak të mençur i janë dorëzuar inercionit, kurse këta që janë rrush e kumbulla nga t(d)ruri po thonë se Kuvendi nuk do të shpërbëhet, por se kjo është lojë e Hashimit dhe shoqëruesve. Konspiracioni është mekanizëm reflektiv, si për marrje të pushtetit, të të mençurit dhe mjet manipulues për t'i ushqyer injorantët si puna jonë. Gjithmonë dhe në çdo rast strehohemi dhe arsyetohemi me konspiracionin që e bëjnë të tjerët kundër nesh, si faktori më vendimmarrës në politikën globale e që pa neve kjo politikë nuk ka, as kuptim e as përmbajtje. Siç e do vendi dhe kuvendi në raste kur vendi detyrohet të shkojë në zgjedhje të jashtëzakonshme, presidenti i vendit, sipas Kushtetutës së Ahtisarit, bën përpjekje të mos shkohet në zgjedhje duke caktuar mandatarin tjetër për formim të qeverisë dhe vetëm kur shteren të gjitha mundësitë e negociimit, në marrëveshje me subjektet politike, presidenti cakton ditën e zgjedhjeve. Në aspektin moral, kombëtar, njerëzor, shtetëror dhe politik, Ramush Haradinaj bëri shumë mirë që dha dorëheqje para se të shkojë, si i dyshuar, për intervistim në Hagë ku është vendosur dega e Gjykatës Themelore të Muçibabës, e maskuar si Dhoma të Specializuara ku drejtësia dhe padrejtësia do të ndahen sipas parimit etnik, kurse provat janë fare të parëndësishme. Kur jemi te kjo gjykatë e Kosovës (budallenjtë edhe e thonë këtë), a po ju duket se ka ngjashmëri me UDB-në e ish-Jugosllavisë dhe të Serbisë për faktin se numri i madh i të ftuarve për "bisida informative" është emëruar i përbashkët i kësaj gjykatë me OZNA-n dhe UDB-në e dikurshme! Nuk mbeti kush pa u ftuar nga kjo gjykatë, për turp të drejtësisë dhe viktimave. Hashim Thaçi i cili, kah po shkon po e quan veten president i Kosovës, e thirri kryetarin e Kuvendit, Kadri Veselin, që në emër të PAN-it ta propozojë kandidatin për kryeministër të Kosovës, por se Veseli nuk u duk fare me propozim e që bëri shumë mirë, ndonëse kandidat të

fortë për këtë post do të ishim, vogëlsia ime, Milaimi (Zeka) dhe Danushi (Ademi). Vetëm me ne Kosova do të përparonte për faktin se më m..t nuk bëhet! Realisht, në ato çaste dramatike për Kosovën kam qenë, ose jashtë Kosovës ose duke hequr bari të keq në oborrin e shtëpisë, me një fjalë herrje dhe djerrje kohe. Kështu, i papërdorshëm për të kontribuar për të ardhmen e ndritshme për Kosovën. Milaimi u vetofrua për këtë post por, së paku, deri më tani nuk ka asgjë. Pata menduar të bëhet një qeveri politike me kandidatin konsensual dhe i cili nuk do të refuzohej nga askush, Zafir Berishën. Por as kjo nuk ndodhi. Botërisht, Hashim Thaçi, pas ftesës që i bëri Kadrisë, nuk pati adresa të tjera publike, kurse për përpjekjet që janë bërë nën rrogos për një qeveri idiotiko-teknike, nuk kam dhe nuk ka informata të mjaftueshme. Tash, në vend të Hashim Thaçit, Isa Mustafa po sillet si president duke i ftuar të gjitha subjektet politike, përfshirë partnerin e mundshëm të ardhshëm për koalicion, PDK-në, për konsultime për formimin e qeverisë së ardhshme, ende pa u shpërndarë Kuvendi dhe pa u shpallur zgjedhjet e jashtëzakonshme nga presidenti me letra, Hashimi i parë dhe, sinqerisht shpresoj, edhe i fundit.

"Presidenti" i Kosovës, Isa Mustafa, takohet shpesh me Albin Kurtin, kandidatin permanent për kryeministër. "Dashuria" midis LDK-së dhe LV-së është dashuri antologjike dhe patologjike, sikur nga përrallat për Romeo dhe Gjuljetën në Verona të Italisë. Dhe e cila tradicionalisht përfundon me vdekje, jo fizike, por idilike, deri në zgjedhjet e radhës kur kemi pasione të radhës. Si mesit për këtë dashuri është një pjesë e së ashtuquajturës shoqëri civile dhe disa analistë që prostitucionin e kanë ngritur në nivel të artit të mbijetesës dhe jetëgjatësisë. Ua rrisin mendjen se vetëm këta mund ta shpëtojnë Kosovën thuaja se LDK-ja deri më tani ka qenë në koalicion me partitë kineze të Tibetit e jo me PDK-në dhe partitë e tjera. LDK-ja ka qenë pjesë e të gjitha qeverive në Kosovën e pasluftës, hiç këtu qeverinë e përkohshme dhe qeverinë Haradinaj. Pra, tërë kohën ka qenë pjesë e sahanit dhe pjesë e legenit. LV-ja nuk ka qenë pjesë e asnjë qeverie, prandaj ende është ekuacion i panjohur në nivelin qendror. Në nivelin lokal, sidomos me Prishtinën, ka dëshmuar se asgjë nuk dallon nga partitë e tjera, madje po të bëheshin bashkë të gjithë ish-kryetarët e Prishtinës, të Titos dhe të Isa Mustafës, nuk do ta degradonin Prishtinën sa e ka shkatërruar Shpend Ahmeti duke e shndërruar

në Kandahar të Kosovës dhe Eldorado të korrupsionit. Shpendkeqja ka qenë perlë e LV-së në zgjedhjet lokale dhe pasi e bleu partinë e Katjushës, ia ktheu Albinit si mos më keq! Albini e nxori Shpendin nga shishja, pasi u rrit dhe iu mprehën dhembët. Dihet se fëmija, të parin që e kafshon pasi t'i dalin dhembët, janë ushqyesit e tij, nëna dhe babai. E pse Shpendi, si fëmijë i rritur dhe i lazdruar do të bënte përsjashme?!

"Presidenti" Isa Mustafa po bënë llogari si ekspert i institucioneve mikrofinanciare që të mbysin me kamata të larta, mbi 30 për qind. Edhe ai, pa u mbajtur zgjedhjet, po llogarit se LDK-ja fiton vota sikur këto institucione mikrofinanciare, prandaj po i thërret kredimarrësit duke ua parashtruar dhe imponuar njëanshëm kushtet e kontratës. Me Albinin është në dashuri me elemente sadiste dhe mazokiste; i shkakton vuajtje Albinit (sadiste) duke i dhënë shpresë për një koalicion parazgjedhor ku Albini do të jetë kryeministër dhe mazokiste, i shkakton vuajtje vetes duke u përballë me sharje, fyerje dhe sulme fizike pikërisht nga partia e zotit Kurti. Definitivisht, në raportet midis Isa Mustafës dhe Albin Kurtit është, te të dy këta i theksuar sindroma i Stokholmit apo tregim i mëshirës ndaj xhelatit - dhunuesit! LDK-ja mund edhe të dalë partia fituese, jo pse është e fortë, por se të tjerët janë të lodhtë, me një dallim të papërfillshëm të votave. Si e tillë, nëse nuk hyn në koalicion parazgjedhor me LV-në, fitorja do t'i shkaktojë shumë probleme pas zgjedhjeve; do të ketë problem ta formojë qeverinë pa pranuar kushte që për të do të jenë të rënda dhe do të detyrohet të bëjë koalicion me partinë që, sipas ideologut të shquar të LDK-së, Ismet Beqiri, kanë vendosur jo një, por dy vija të kuqe, PDK-në. Në Kuvendin e fundit të LDK-së Isa Mustafa e ka shpëtuar këtë parti nga një ndarje dhe çarje të madhe duke e mbështjellë ndarjen e brendshme ekzistuese me një cipë të unitetit mashtrues e cila mund të shpërthejë nëse LDK-ja mbetet pa pushtet apo nëse të fortit e LDK-së i lë anash, jashtë grazhdit dhe në mëshirën e grabitçarëve apo jeniçerëve të kësaj partie. Nuk ka më analfabetizëm në politikë dhe jo vetëm në politikë kur bashkëpunimin e kushtëzoni me vizitë dhe përkuje para një varri. Këtë po e kërkon LDK-në nga LV-ja sepse programin politik e ka ndërton dhe po e ndërton nga varri. LDK-në duhet të bëjë kompromis me LV-në nëse mendon të bashkëpunojë, siç thonë ata, për të mirën e Kosovës. Por, jam i sigurt se koalicioni LDK dhe LV në planin afatgjatë nuk funksionon, e sidomos jo nëse shkohet me një

listë zgjedhore të përbashkët. Ky koalicion hipotetik mund të funksionojë më së shumti një vit pas formimit të qeverisë.

LV-ja ishte subjekti që mori më së shumti vota në zgjedhjet e fundit nacionale, mirëpo rritja e shpejtë shkaktoi edhe ndarje të shpejtë. Fatosat dhe fatoset e Kaçushës e ndanë rrugën me LV-në duke keqpërdorur bazën votuese dhe besimin e votuesve. Por kështu e ka politika. LV-ja, në vend se të lë hapur një deriçkë për bashkëpunim me PSD-në, filloi një sulm frontal ndaj tyre dhe në këtë mënyrë ndihmuan dhe ndikuan në faktorizimin e PSD-së. LV-ja, me qëndrim inatçor ndaj PSD-së, ka faktorizuar këtë subjekt politik. Albin Kurti këmbëngul të bëhet kryeministër, si më i votuari në Kosovë. Në aspektin logjik edhe ka të drejtë, kurse është treguar miop në këtë kërkesë për faktin se rrethanat apo yllësia ndërkombe të favorizon këtë kërkesë. Prandaj kemi pasur koalicione të detyrueshme dhe joparimore. Prandaj LV-ja ka mbetur në opozitë dhe duket se edhe kësaj radhe do të mbetet në opozitë. As koalicioni eventual me LDK-në nuk siguron se LV-ja do ta ndajë pushtetin e aq më parë se do ta udhëheqë qeverinë e ardhshme. Insistimi që me çdo kusht të hyhet në koalicion me LDK-në, e që krijon një situatë vardisëse, nuk i shkon LV-së që ka qenë opozita e vetme në Kosovë, që nga themelimi i saj. Duhet pranuar se LV-ja ka bërë më së shumti ndryshime sikur që edhe vetë Albin Kurti ka ndryshuar, mirëpo ende janë në fazën e testimit të besimit ndërkombe. Albin Kurti është trim, patriot dhe thellë jam i bindur se materialisht është i pakorruptuar. Prandaj edhe nuk është koha e tij! Mbase pas katër vjetëve Albin Kurti edhe mund të bëhet mesi i politikës kosovare nëse deri atëherë nuk do të ketë luftë në Kosovë apo nëse Kosova do të mbijetojë me këta kufij. Janë shumë të panjohura që presin përgjigje. LV-ja dhe Albin Kurti nuk duhet të kenë vija të kuqe as ndaj PDK-së e as ndaj PSD-së e as ndaj asnjë subjekti tjetër politik apo personaliteti. Marrja dhe bërja e politikës është aktivitet social, kurse hatërmbetja krijon një mjedis jobashkëpunues dhe josocial. Aderimet e fundit në LV-në nuk sjellin fare vota të reja, përveç emra dhe mbiemra të politikanëve të cilëve u janë zbratur bateritë në subjektet e tjera, madje edhe duke e luftuar LV-në dhe tash duan t'i mbushin këto bateri politike dhe kombëtare në LV, duke zënë një vend ku karikohen lehtë dhe shpejt apo, ku do të sistemohen pa dhënë ndonjë kontribut paraprak në LV. AAK-ja bëri koalicion të papritur

me PSD-në e Shpendkeq Ahmetit. AAK-ja, sipas meje, do të ketë rritje të votave në saje të lojës politike të luajtur nga kryeministri Haradinaj. Hardinajt nuk ia fali askush ata pesë (5) minuta, por ia krijoi vetes dhe e luajti lojën perfekt, pa i munguar ndershmëria. Ndershmëria sipas standardeve të Kosovës! PSD-ja mbeti në lojë politike pasi bëri koalicion me AAK-në dhe këtë e ruajti si atur rezervë pasi në Komunën e Prishtinës u turpëruan me keqqeverisje. Koalicioni me AAK-në ia rritë nivelin e përfaqësimit politik, nga ai lokal në atë qendror dhe, duke ua siguruar mbijetesën politike, u siguron imunitet, për një kohë të caktuar edhe nga përgjegjësia penale. Edhe ky është standard i Kosovës. AAK-ja do të bëjë përpjekje të marrë edhe ndonjë subjekt politik si puna e AKR-së e cila nuk i duhet as drejt, përveç pronarëve të kësaj partie që me asgjë nuk e kanë merituar pushtetin e pakufishëm që iu është dhënë, fillimisht nga Hashim Thaçi dhe të tjerët, të korruptuar skajshmërisht materialisht, politikisht, kombëtarisht, njerëzisht, pra në të gjitha aspektet. Sa për Nismën nuk e besoj se Fatmir Limaj do ta fusë kokën në kapelën e Ramushit për faktin se konsideron se është kokë më e madhe se vetë Ramushi. Pas zgjedhjeve mund të ndodhin edhe koalicione dhe lidhje që nuk i kap as truri i Sahit Plisit. Tash në treg ka dalë edhe Alternativa për Kosovën, me emër të madh por, thuaja pa anëtarësi, duke e vendosur një çmim të lartë për lëkurën e tyre politike. Po e vlerësojnë këtë lëkurë më të shtrenjtë se të ishte e krokodilit apo aligatorit. Alternativa për Kosovën mund të sigurojë vota aq sa zë një qese najloni për 100 gramë boronica. Edhe një emër tjetër ku vegjetojnë sekserët e certifikuar dhe të noterizuar edhe nga gjykatat e Kosovës, e quajtur Lista Rugova, po ka tendencë kontrabandimi në tregun politik të Kosovës, përkatësisht eksponenti në inteligjent i saj, Dardan Gashi. Realisht këta nuk kanë fare vota dhe jam i sigurt se edhe kur voton Dardani apo tjetri, nuk votojnë për veten e tyre, por për PDK-në ose AAK-në, varësisht nga thesi me tagji që u shërbehet në grazhd. Por, duhet të pranohet se nuk ka përfitues më të pamërituar e grazhdit, që nga përfundimi i luftës deri më sot, se AKR-ja dhe tovarish Begja. PDK-në nuk e do askush publikisht, ndërsa prapa perdeve i lëshojnë brekët të gjithë kur ata i thërrasin. Edhe ky është standard kosovar. Po të mos ishin vijat e kuqe, besoj se PDK-ja do të dilte partia e tretë apo e katërt. Tash, pas këtij mllëfi, sidomos të disa partive politike dhe individëve me të kaluar jugosllave dhe serbe

ndaj PDK-së, aksionet e kësaj partie janë rritur dukshëm dhe, po të shkohej në zgjedhje veç e veç, do të vija bast se PDK-ja do të fitonte zgjedhjet apo, në rastin më të keq, do të dilte e dyta. Te shqiptarët diçka që është e ndaluar dhe e cila vihet në pozitën e viktimës kanë më së shumti përkrahje, qoftë nga mëshira apo nga kureshtja. Në fund të fundit, a nuk u përzunë nga parajsja Adami dhe Eva shkaku se e kafshuan mollën e ndaluar?! PDK-në, përkatësisht personat e kriminalizuar brenda kësaj partie, në emër të luftës dhe partisë nuk lanë të zezë pa bërë pas përfundimit të luftës dhe përsëri kjo parti mbijetoi. U ndanë në krahun e Hashimit dhe të Jakupit dhe Fatmiri jo për shkak të idealit apo programit politik, por për shkak të luftës për pushtet. Dhe përsëri mbijetuan. Kjo ndarje, për shkak të pushtetit, u bartë edhe në disa komuna dhe përsëri mbijetuan. Kjo do të thotë se kjo parti kishte një strukturë mirë të organizuar, prandaj edhe mbijetoi. Me PDK-në askush nuk do të bëjë koalicion, madje as Alternativa për Gjakovën, gjiganti AKR dhe u mbetet i vetmi partner LB-ja, nëse PDK-ja është për ndryshim të kufijve me Serbinë. Alternativa e Edita Tahirit është në fazën e hibnacionit permanent, në gjumë të thellë, me metabolizëm të aktivizimit politik, diku mbi 0.01 për qind. Nëse kemi parasysh të gjitha këto, është çudi si PDK-ja ka mbijetuar deri më tani. Nëse përsëri i marrim parasysh ato që u cekën më lart, atëherë PDK-ja nuk do të ndahet keq në këto zgjedhje dhe për këtë i ndihmojnë shumë vijat e kuqe që ia kanë vendosur ato vija dhe të cilat edhe vetë duhet të jenë të kornizuar me vija të kuqe. Po thonë se PDK-ja nuk mund ta luftojë korrupsionin sepse vetë është e korruptuar siç janë dhe ishin të gjitha subjektet e tjera politike, pa përjashtim. Duhet ta kenë parasysh se pickimi i gjarprit nuk shërohet me paracetamol apo me ndonjë antibiotik, qoftë edhe i fuqisë së madhe, por nga serumi i përgatitur pikërisht nga helmi i gjarprit. Lufta e madhe bëhet vetëm brenda llojit dhe kjo luftë është e pamëshirshme, prandaj edhe jep rezultate. Përfundimisht, koalicionet pas zgjedhjeve do të jenë përcaktuese për qeverinë dhe mënyrën e qeverisjes, por se nuk pres ndonjë ndryshim cilësor pavarësisht se kush do të qeverisë. Jo se nuk ka vullnet dhe gatishmëri për këtë, por se proceset politike, bisedimet idiote për statusin me Serbinë, do të jenë kushtëzim dhe pengesë për luftimin e dukurive negative. Po e shohim që ndrikullat ndërkombëtare që e kanë lidhur dhe vazhdojnë ta lidhin çdo kërthizë në Kosovë, Serbinë po e konsiderojnë si kërthizën kryesore në Ballkan rreth së cilës duan t'i lidhin të gjitha kërthizat, pa e prekur e lëre më dëmtuar kërthizën e Serbisë.

Përfaqësuesit e OEAK-ut prezantojnë propozimet e tyre për qeverinë e re

Përfaqësuesit e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK) kanë paraqitur ankesat dhe kërkesat e tyre drejtuar qeverisë së re. Ndër prioritetet kryesore për qeverinë e re, sipas tyre, do të duhej të ishin: stabiliteti i energjisë elektrike, subvencionimi i prodhimeve vendore dhe qasja më e lehtë në financa. Po ashtu, edhe vëmendje e posaçme për shkollat profesionale, respektivisht punëtorët e kualifikuar

EPOKA E RE | Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 20 GUSHT - Përfaqësuesit e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK) kanë organizuar të martën tryezën me temë "Gjendja e prodhimit në Kosovë", ku përfaqësuesit e bizneseve prodhuese të Kosovës kanë paraqitur ankesat dhe kërkesat e tyre drejtuar qeverisë së re. Me këtë rast, kryetari i OEAK-ut, Arian Zeka, ka numëruar disa prej problemeve me të cilat po përballen bizneset në Kosovë. "Disa lidhen me fuqinë punëtore që kanë zënë vend si ankesat më të fuqishme. Janë disa çështje të kryerjes së pagesave dhe Ligji për tregtinë e brendshme që ka qenë në proces i cili do të jetë një prej ligjeve me prioritet për qeverinë e re", u shpreh ai.

Kurse Kujtim Gjevori nga kompania prodhuese "Scampa" ka thënë se ndër problemet kryesore të kompanive janë: mungesa e energjisë elektrike, qasja në financa, si dhe shkolla profesionale për të nxjerrë punëtorë të kualifikuar. "Ka pasur zhvillime në industrinë e prodhimit në Kosovë, por nuk do të thotë me u ndal me kaq. Kemi edhe probleme të tjera. Për shembull, energjia elektrike po shohim se do të ketë ngritje,



prandaj duhet bërë një listë për çmimore të energjisë elektrike, pasi sot paguhet njëjtë si për amvisëri si për industri. Është me rëndësi të bëhet tash e jo më vonë pasi, po qe se ngrehet çmimi, do të rritet edhe kostoja e prodhimit dhe mund të na bëjë jokonkurrentë", ka deklaruar Zeka. Ndërkaq Bajram Rushiti nga furra "Buka" ka thënë se ende duhet punë për ta rregulluar qasjen në financa. "Sa i përket qasjes në financa ka shumë vend. Vetëm vitin e kaluar kemi humbur para në trust, unë për vete 1 600 euro", ka thënë Rushiti, duke shtuar se duhet të fillojë subvencionimi edhe për prodhuesit. "Do të ishte mirë të subvencionohej prodhuesit. Subvencioni edhe në energji elektrike do të ishte i mirëseardhur", u shpreh ai. Kurse Gojart Kelmendi nga

kompania "Flutura" pati disa propozime për qeverinë e re, që përfshijnë strategjinë për eksport të produkteve vendore, subvencionet, shkollat profesionale etj. "Një propozim për qeverinë e re do të ishte një strategji afatshkurtër dhe afatgjatë me qëllim të zhvillimit të sektorit prodhues. Kosova është e vetmja që nuk ka një strukturë të tillë. Jemi një shtet që mbi 90 për qind jemi importues dhe qëllimi i qeverisë së re është një strukturë që do ta zhvillonte sektorin prodhues. Të gjithë ne prodhuesit po kemi problem me financimet e bankave komerciale. Shteti duhet të krijojë një bankë shtetërore. Qeveria e re do të duhej t'i subvenciononte prodhuesit e rinj me makineri që të zbutet edhe papunësia. Pikë tjetër janë shkollat profesionale.

Një prej problemeve janë kuadrot e punëtorëve. Nuk kemi kuadro të profesionalizuar", ka deklaruar Kelmendi.

Kurse Ylber Bajraktari nga "StoneCastle" ka thënë se çdoherë e më shumë po vërehet mungesë e kuadrove profesionale punëtore. "Kompania jonë ka ardhur në situatë ku një punëtor yni i mbikëqyrë pesë hektarë të rrushit. Një faktor është emigracioni dhe tjetra mosmbështetja e qeverisë. Subvencione nuk u ka gëzuar kompania jonë deri vitin e kaluar përmes gjykatës. Tjetër është lirimi nga akciza. Në Kosovë jemi të detyruar ta mbushim arkën e shtetit për të dalë me pjesëmarrje në treg", u shpreh Bajraktari. Ai ka kërkuar që për çdo litër eksport të produkteve të kompanisë të subvencionohen prej 10-15 centësh.

Sot grevë gjashtëorëshe në Aeroportin 'Adem Jashari'

EPOKA E RE | Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 20 GUSHT - Rreth 500 punëtorë të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" kanë mbajtur edhe të martën grevë dyorëshe, nga ora 08:00 deri në orën 10:00, ndërsa edhe për sot (e mërkurë) është paralajmëruar grevë gjashtëorëshe.

Kryetari i Sindikatës së Punëtorëve të Aeroportit, Bashkim Latifi, ka thënë se 250 punëtorët e ndërrimit dhe 250 punëtorët e tjerë kanë kërkuar të martën plotësimin e pesë kushteve të tyre. Latifi ka thënë se të hënën kanë provuar të zhvillojnë dialog me zyrtarët e Aeroportit dhe kanë zbritur në dy kërkesa në mënyrë që të vazhdohet puna, mirëpo as atëherë nuk janë marrë parasysh. Sipas tij, në rast se kërkesat e tyre nuk plotësohen, aeroporti do ta vazhdojë grevën edhe të mërkurën. "Kuvendi i sindikatës ka votuar të hënën që nëse nuk plotësohen kërkesat tona të mërkurën, të mbahet grevë prej gjashtë orësh", ka thënë Latifi. Ai ka



theksuar se kërkesat e punëtorëve të aeroportit janë: të paguhet rrezikshmëria në vendin e punës sipas ligjeve të punës në Kosovë, të bëhet nivelimi i pagave, të paguhet përvoja e punës, të paguhet orët e punës gjatë fundjavës dhe të paguhet një shujtë ditore. Si rrjedhojë e kësaj greve në ANP "Adem Jashari" kishte vonesa të fluturimeve për linjat e orës 08:00 deri në orën 10:00, derisa janë paralajmëruar masa ligjore për secilin punëtor veç e veç. "Dëshirojmë ta informojmë publikun se fluturimet e parapara nga ora 08:00 deri në

orën 10:00 mund të kenë vonesa. Kjo rrjedh si pasojë e kërcënimeve të vazhdueshme nga punonjësit që janë pjesë e grevës ndaj punonjëseve që janë të gatshëm të punojnë. Andaj u kërkojmë ndjesë të gjithë udhëtarëve për vonesa, meqenëse ne kemi marrë të gjitha masat paraprake për grevë, mirëpo duke u bazuar në takimin e së hënës me udhëheqësin e Sindikatës së ANP-së, ne nuk kemi marrë në konsideratë se do të ketë veprime jashtë kornizave ligjore të grevave për ta penguar procesin e punës. Menaxhmenti i ANP-së do

t'i shqyrtojë të gjitha rastet veç e veç dhe do të marrim masa ligjore ndaj personave përgjegjës!", është thënë në njoftimin e ANP-së.

Ndërkaq Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës (AACK) u ka bërë thirrje të gjitha palëve që t'i shfrytëzojnë të gjitha mundësitë e dialogut social për të gjetur një zgjidhje të pranueshme për palët dhe ndërprerje të grevës në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës.

Përmes një njoftimi për media ata thonë se inspektorët e AACK-së gjatë kohës së grevës kanë vëzhguar nga afër vijimin e operimeve në pajtim me rregullat dhe standardet e zbatueshme për siguri të operimeve dhe nuk kanë vërejtur parregullsi. "Greva pritet të vazhdojë edhe nesër më 21. 08. 2019 nga ora 08:00 deri në orën 14:00. Lutem udhëtarët që t'i përcjellin komunikatat e ANP 'Adem Jashari' dhe ta planifikojnë itinerarin e udhëtimeve në bashkëpunim të ngushtë me kompanitë ajrore apo përfaqësuesit e tyre", thuhet në njoftimin e AACK-së.

Me rastin e njëvjetorit të vdekjes së Adem Demaçit, 26 korrik 2018 (22)

ADEM DEMAÇI, HERO I KOSOVËS DHE NDERI I KOMBIT

- Përshtypjet në "librin e zisë"



**Përgatiti Selatin
NOVOSELLA**

Vepra juaj në shërbim të atdheut, të kombit e të lirisë do të mbetet udhërrëfyes për ne! Të fale-minderit, Baca Adem!

30 korrik 2018,
Sefer dhe Mihrije Birnxhiku,
Çubrel, Skenderaj

Baca Adem Demaçi, padyshim se vazhdon të jetojë, pasi ka lënë vepër madhështore. Vazhdon të jetojë vepra e tij, shembulli i tij. Andaj ai është i gjallë përherë!

31 korrik 2018,
Emrush Xhemajli

Baca Adem, një jetë të tërë ia kushtove programit për bashkimin kombëtar! Betohe mi se me tërë qenien do punojmë bashkë me shokë që atë betim ta bëjmë realitet! Të qoftë lavdi! Të qoftë i lehtë dhe i tokës mëmë për të cilën shkruve çdo gjë!

31 korrik 2018,
Shemsi Sylja

Bacë! Atë që gjarpërinjtë e gjakut nuk mundën ta bëjnë, ta bën korbat e zi! Por, ti je i pavdekshëm në zemrat e popullit dhe të patriotëve!

31 korrik 2018,
Behare Rexhepi

Heronjtë nuk vdesin kurrë! Ata jetojnë me ne dhe në ne! Lavdi jetës dhe veprës së bacës Adem!

31 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Kam qenë i nderuar në këtë botë, që kam njohur Adem Demaçin, që nga fëmijëria, kur e kam parë gjatë vizitës të vëllai Shaniu, në Burgun e Stara Gradishkës! I pavdekshëm do të mbetet kujtimi për bacën Adem!

31 korrik 2018,
Zafir Berisha

Lavdi Simbolit të rezistencës kombëtare, bacës, Adem Demaçi!

31 korrik 2018,
Xheladin Sfeçla

Ndihem krenar sa herë kujtoj veprën tënde të pakrah-sueshme për nga pesha dhe vlera, e cila sa vije e zmadhohet. Ishe mësuesi ynë se si duhet atdheu, shembulli i sakrificës mbinjerëzore për të drejtat e njeriut dhe lirinë, të cilën aq shumë e deshe! Rrugën e cila ishte plotësisht e errësuar na e le të ndriçuar me dritë hyjnore. Le të mbetet i paharruar kujtimi për ty dhe le të ndihemi krenar të gjithë, edhe pasardhësit tanë, sa herë e kujtojnë veprën tuaj aq të lartë! Me respekt të thellë dhe kujtim të përhershëm për ty, bacë!

31 korrik 2018,
Hajrullah Mehmeti

Me shumë respekt për ty, baca Adem! Nderimet tona do mbesin gjithmonë për ty, baca jonë! Ti nuk ke vdekur! Ti jeton gjithmonë!

31 korrik 2018,
Sanije Sadiku

Me respekt dhe nderime meritore, për bacën Adem Demaçi! Të deshëm për të gjallë, si ideal të patëm, të tillë do të ruajmë përgjithmonë!

31 korrik 2018,
L. Krasniqi

Jemi krenar që të patëm në mesin tonë, edhe në familje, që u inkurajua me veprën tënde dhe fjalët plot atdhedashuri. Ishe shembulli i sakrificës sublime për atdhe, udhërrëfyes sesi duhet të jetohet me nder për shqiptari, sesi duhet të jetohet me nder dhe frymëzim për gjeneratat e reja. I lehtë të qoftë dhe i Kosovës dhe i Shqipërisë, për të cilën sakrifikove rininë, dhe ishe i gatshëm të flijoheshe edhe pas daljes nga burgu. Lavdi jetës dhe veprës së bacës Adem, bacës së Shqipërisë!

Me respekt të përjetshëm!
31 korrik 2018,
Familja Vata nga Sallagrazhda

I madh linde, i madh mbetesh, bacë!

31 korrik 2018,
Jemin Krasniqi

Nderime e lavdi e përjetshme Kolosit të madh të kombit dhe të çështjes kombëtare, Bacës, Adem Demaçi! Baca ishte dhe mbetet frymëzim edhe për brezat e ardhshëm. Ai ishte frymëzimi ynë në çdo aktivitet dhe demonstratë që kemi bërë, që nga viti 1968!

31 korrik 2018,
Latif Zariqi



Baca Adem, ti ishe një pishtar, një qiri që dogje vetën të na bësh dritë në rrugën tonë. Na le në mes të rrugës, baca Adem! Kush do të na e ndriçoi rrugën tonë si ti? Lavdi jetës dhe veprës së bacës Adem!

31 korrik 2018,
Florim Kuliqi, Drenas

Me respekt të lartë për bacën Adem! Vepra e tij nuk do të vdes kurrë!

31 korrik 2018,
Muhamet Konushefci

Dhe të qoftë i lehtë, baca Adem! Shpirti jot pushoftë në tokën e Kosovës, në tokën e atdheut tënd!

31 korrik 2018,
Sabit Kadriu

Adem Demaçi e ka lënë ndezë dritën e mirësisë pas vetes! I përjetshëm qoftë kujtimi për Te!

31 korrik 2018,
Institucioni i Avokatit të Popullit

Baca Adem, ke qenë, dhe do mbetesh frymëzim i brezave, Ylli i shqiptarëve!

31 korrik 2018,
Myzafere Baraliu

Bio je veliki ?ovek i veliki borac za prava Alban-skog naroda i nezavisnost Republike Kosovo! Republika Kosovo, i svi njeni gradjani duguju mu zahvalnost, njegovoj odanosti i borbi za blagostanje, za mir i slobodu, koju danas u-ivaju.

31 juli 2018 S' v e l i k i m
poštovanjem, Dr. Sulejman

Ugljanin, Predsednik Bosnjackog Nacionalnog, Vijeca SAND-AKA

Jo, jo nuk ka vdekur Adem Demaçi! Ai do të jetojë sa të ekzistojë kombi shqiptar. Kujtimi për Bacën do të jetë i përherëshëm. Lavdi veprës së tij. Lavdi jetës që e jetoj dhe lavdi lirisë së popullit dhe atdheut!

31 korrik 2018,
Shefik Sadiku

Baca Adem!
Jam i vetëdijshëm se erdhe në kohën sa ishe gjallë në këtë botën tonë, i ke parë shqiptarët tu (edhe t'mitë) që "pak" kanë dal nga rruga e duhur. Shpresoj që ata ta dinë se sa jetë njerëzish janë sakrifikuar për këto ditë të Lira e në Liri! Lavdi për jetën dhe veprën që na e le!

31 korrik 2018,
Riza Baftiu

Iu shprehu ngushëllime familjes së Adem Demaçit! Qoftë lëndua toka jonë, që dha ketë burrë!


31 korrik 2018,
Nazmi Llapashtica

Vigan i dy shekujve shqiptar! Respekt për viganin tonë, bacën Adem!

31 korrik 2018,
Ahmeti, Skenderaj

Baci Adem na i la veprat që ne të mësojmë si duhet dhe të mbrohet kombi e atdheu! Respekt për bacën Adem!

31 korrik 2018,
Elheme Hetemi



Faksimil i përshtypjes të Emrush Xhemajlit,
ish-kryetar i LPK-së

(Vazhdon në numrin e
ardhshëm)

Portrete atdhetarësh

Muhabi Azemi, një vullkan i heshtur shqiptar!

Ismet RASHITI

Janë tetë dekada jetë në shërbim të lirisë, pavarësisë dhe bashkimit kombëtar që flenë si një vullkan i heshtur në Sllatinë të Epërme të Vitisë, në lagjen e njohur për atdhedashuri të Kupecëve.

Janë tetë dekada jetë që atdhetari Muhabi Azemi pa zhurmë e pa fjalë të mëdha ka punuar në heshtje për çlirim kombëtar dhe për një të ardhme më të mirë të popullit shqiptar. Liria, emancipimi, arsimimi dhe përparimi kanë qenë oksigjeni dhe ajri i këtij sllatinasi atdhetar, i cili tashmë ka mbushur tetëdhjetë vjet jetë. Lindi më 25 tetor 1938 në një familje intelektualësh dhe atdhetarësh të njohur në Anamoravë dhe më gjerë. Jeta e vështirë ekonomike kishte bërë që Muhabi Azemi qysh në vitin 1962, i detyruar nga gjendja e vështirë ekonomike, të shkonte në Beograd si punëtorë krahu për sigurimin e kafshatës së gojës. Me gjithë jetën e vështirë ekonomike, Muhabiu kishte arritur ta kryente shkollën fillore shtatëklasëshe në Sllatinë të Epërme, kurse klasën e tetë e përfundon në Beograd po në vitin 1962. Në këtë vit ishte martuar me zonjën Bahrije Shala nga fshati Mirosalë me të cilën kanë pesë fëmijë: Vedati, Nehati, Miniremja, Imriu dhe Fahrushi.

Ishin këto vitet më të rënda për popullin shqiptar. Aksioni famëkeq për mbledhjen e armëve, mungesa e shkollave në gjuhën shqipe, mungesa e universitetit dhe ndalimi i Flamurit Kombëtar, Muhabi Azemin e ndiqnin mbrapa si një hije e zezë ngado që sillej në rrugët e Beogradit dhe e gërryente nga brenda shpirtin e



tij lirisdashës.

Në vitin 1963 fillon punën në ndërmarrjen ndërtimore "Granit" të Shkupit. Puna e rëndë fizike që bënin shqiptarët dhe padrejtësitë e shumta e preokuponin së tepërmi. Papritmas i shfaqeshin para syve "shiftarët me bishta", siç i quanin poetët dhe shkrimtarët shovinistë serbë. Në këto rrethana regjistrohet në shkollën njëvjeçare të quajtur Stenodaktilografike të cilën e mbaron me sukses. Etja për dije dhe arsimim e përcjellë gjatë gjithë kohës. Gjatë qëndrimit në Shkup ka ndjekur dhe ka kryer me sukses po ashtu kursin për mjeshtër i kualifikuar të ndërtimtarisë. Dëshira për t'u shkolluar edhe më tej ishte bërë pengesë për maqedonasit, ndaj e transferojnë në Zajaz të Kërçovës, fshat ky krejtësisht i izoluar, ku nuk kishte asnjë perspektivë.

Një vit para demonstratave historike të vitit 1968, Muhabi

Azemi punësohet si daktilograf dhe pastaj si përkthyes në Gjykatën Komunale të Vitisë. Etja për liri e përcjell hap pas hapi. Aty ku ishte përpiquej të gjente mënyra për propagandimin e çështjes kombëtare shqiptare dhe t'i ndihmonte shqiptarët brenda mundësive që kishte në institucionin ku punonte.

Në vitin e kthesës së madhe politike të demonstratave për Republikën e Kosovës, në prill të vitit 1981 ka filluar veprimtarinë ilegale bashkë me Xhemajl Rashitin, Xhevat Hazirin, Nazim Azemin Vahedin Azemin, Daut Azemin, Faton Topallin, Ismet Azemin e tjerë. Në rrethana tepër të rënda politike të asaj Pranvere të Madhe, Muhabi Azemi shtypë trakte, parulla e materiale tjera organizative për Republikën e Kosovës. Janë të rrallë njerëzit si Muhabi Azemi që tërë jetën punojnë në heshtje e digjen ngadalë si kandili për të mirën e atdheut. Muhabi Azemi

gjithnjë ka qenë në rolin e këshilltarit me përvojë për gjeneratat e reja. Ai ka ditur si të sillet, e si veptoi pa zhurmë të madhe e pa rrahagjokse. Në fakt familja Azemi gjatë viteve të rënda të diferencimit politik ka qenë një ndër familjet më të vendosura, por edhe më të përndjekura nga soldateska serbe. Arsintari Xhelil Azemi, assesi nuk pranonte ti dënonte e të diferencuhej nga vëllazëritë dhe kushërinjtë siç kërkonte me kërcënime UDB-ja, ndërsa Nazim Azemi si i burgosur politik disa vite rresht, ishte simbol i qëndresës dhe vendosmërisë në burgjet e tmerrshme serbe. Pavarësisht torturave nuk dhanë asnjë sekret dhe asnjë emër veprimtarësh. Në këtë frymë veptoi pa u ndalur edhe veprimtari i heshtur, Muhabi Azemi.

Në mars të vitit 1982, grupi

Gjatë gjithë këtyre viteve të vështira, veprimtari i paepur, Muhabi Azemi ka arritur të mbijetojë nga skamja e varfëria, duke u marrë me punë të rënda fizike vetëm e vetëm që të mos gjunjëzohet para armiqve. UDB-ja asnjëherë nuk arriti ta thyej idealin e tij për liri, pavarësi e bashkim kombëtar që ishte trashëguar brez pas brezi në familjen Azemi.

Në kushte të vështira i rritë dhe i shkollon aq sa mundet të pesë fëmijët, sado që për shkak të gjendjes së vështirë Nehati kishte marrë rrugën e kurbetit, ndërsa më i madhi Vedati, i ndërpret studimet për shkak kushteve të vështira ekonomike.

Gjatë demonstratave të vitit 1989 fëmijët e Muhabi Azemit, ishin aktiv në demonstrata e protesta kundër okupimit klasik serb. Në luftën çlirimtare, Imri



illegal ishte zbuluar nga organet e UDB-së serbe. Pas rrethimit të hekurt të lagjes Kupec shumë pjesëtarë të kësaj familje atdhetarësh janë arrestuar e maltretuar së tepërmi nga hetuesit. Në pamundësi që të zbulonin rrjetin organizativ në tërësi dhe falë deklaratave pozitive të kryetarit të Gjykatës Komunale të Vitisë, atë kohë Abdylaziz Sadiku që kishin krijuar rrethana lehtësuese, Muhabi Azemi dënohet me dy muaj burg dhe përjashtim të përjetshëm nga puna. Ky dënim nuk e tremb fare Muhabin as nuk e ndalë së vepruari për çlirimin e Kosovës. Shtëpia e tij gjithnjë ka qenë në shënjestër dhe është konsideruar nga UDB-ja si "Çerdhe e nacionalizmit shqiptar".

Ndjekja dhe marrja në biseda informative nga siguri shtetëror serbndaj Muhabi Azemit nga fshati Sllatinë e Epërme të Vitisë, ka vazhduar edhe gjatë viteve 1988-1989.

Azemi kyçet në radhët e UÇK-së, tani në radhët e FSK-së, ndërsa djali më i vogël Fahrush Azemi përveç që ka treguar sukses te madh gjatë studimeve, tashmë ka bërë emër si arkitekt i njohur. Ai njihet si projektues i shumë objekteve ndërtimore në Kosovë dhe më gjerë. Po ashtu, Fahrush Azemi është emër i njohur për të gjithë edhe si këngëtar i muzikës popullore e qytetare. I rritur dhe edukuar në frymë patriotike nga babai, Fahrushi me krenari dhe dëshirë të madhe këndon këngë patriotike për dëshmorët, për luftën çlirimtare dhe lirinë. Si i tillë ka krijuar emër dhe çmohet së tepërmi nga shqiptarët e të gjitha trojeve.

Atdhetari Muhabi Azemi gjatë gjithë jetës së tij veptoi si një vullkan i heshtur për të mirën e kombit shqiptar, për të mirën e njerëzimit në përgjithësi. Gjithsesi kundër shtypësve e tiranëve, kundër shovinistëve dhe okupatorit klasik serb.



Pompeo: IS është fuqizuar në disa rajone

UASHINGTON, 20 GUSHT - Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, pranoi se grupi militant ekstremist Shteti Islamik (IS) po fuqizohet në disa rajone, mirëpo shtoi se kapacitetet e

grupit militant për të kryer sulme janë zvogëluar. "Është çështje e komplikuar. Pa dyshim se ka vende ku IS është më i fuqishëm sot sesa ka qenë tre apo katër vjet më parë", tha

Pompeo në një intervistë për CBS.

Por, ai theksoi se kalifati i vetëshpallur nga ana e grupit është mposhtur dhe se kapacitetet për ta sulmuar janë bërë shumë më

të vështira.

Grupi militant mori përgjegjësinë për sulmin gjatë fundjavës në Kabul të Afganistanit, ku humbën jetën 63 persona dhe 182 të tjerë u plagosën.



Rusia akuzon ShBA-në për nxitje të tensioneve ushtarake

Zëvendësministri i Jashtëm rus Sergei Ryabkov ka thënë se testimi i raketës tokësore në Kaliforni është shkaku i keqardhjes dhe ShBA-ja shihet se është nisur drejt nxitjes së tensioneve ushtarake



MOSKË, 20 GUSHT - Moskë ka akuzuar Shtetet e Bashkuara për nxitje të tensioneve ushtarake pas testeve të raketës së parë, prej kur është larguar nga Traktati për Armë Bërthamore, të cilin e kishte nënshkruar me Rusinë tri dekada më parë.

Zëvendësministri i Jashtëm rus, Sergei Ryabkov, është cituar të ketë thënë për agjencinë e lajmeve TASS se testimi i raketës tokësore në Kaliforni është "shkaku i keqardhjes".

"Shtetet e Bashkuara shihet se janë nisur drejt nxitjes së tensioneve ushtarake. Ne nuk do të reagojmë ndaj provokimeve", ka thënë Ryabkov.

Shtetet e Bashkuara janë larguar më 2 gusht nga marrëveshja e vitit 1987, e cila ka ndaluar testimet e raketave tokësore dhe atyre balistike me rreze nga 500 deri në 5 500 kilometra.

Shtetet e Bashkuara dhe ish-

Bashkimi Sovjetik kanë pozicionuar raketa të tilla në gjithë Evropën gjatë Luftës së Dytë Botërore, mirëpo ato janë konsideruar destabilizuese për shkak të kohës së shkurtër të fluturimit.

Traktati për Armë Bërthamore nuk ka ndaluar nisjen e raketave nga deti apo ajri.

Departamenti amerikan i Mbrojtjes ka njoftuar më 19 gusht se ka testuar një raketë në Ishullin Shën Nikolla të Kalifornisë.

Pentagoni theksoi se raketa ishte e aftë që të mbante një ngarkesë konvencionale dhe jo armë bërthamore.

Sekretari i ri i Mbrojtjes, Mark Esper, ka thënë se nëse Ushtria amerikane prodhon një sistem raketor plotësisht tokësor, ai do të donte që raketat konvencionale amerikane me rreze të mesme veprimi të diskolohen

në Azi.

Presidenti amerikan Donald Trump ka njoftuar më 1 shkurt se Shtetet e Bashkuara do të largohen nga marrëveshja për Armë Bërthamore, duke akuzuar Rusinë për shkelje të kushteve të këtij dokumenti.

Sipas SHBA-së, Rusia ka zhvilluar dhe testuar raketën, 9M729, të njohur si SSC-8.

Moska ka mohuar pretendimet, duke deklaruar se janë sistemet raketore amerikane në Evropën Lindore që shkelin kushtet e mar-

rëveshjes.

Uashingtoni ka kundërshtuar një deklaratë të tillë.

Pas ShBA-së, edhe Rusia është larguar nga Marrëveshja për Armë Bërthamore, çka ka nxitur shqetësimet për garë të re të armëve mes këtyre dy vendeve.

Dorëhiqet kryeministri italian



ROMË, 20 GUSHT - Kryeministri italian Giuseppe Conte tha se ai do të dorëhiqet, më vonë të martën, pas një vendimi nga partia në pushtet për të paraqitur një mocion mosbesimi ndaj qeverisë së koalicionit. Duke iu drejtuar parlamentit, Conte tha se do t'ia dorëzonte dorëheqjen presidentit Sergio Mattarella, i cili do të duhet të vendosë nëse dëshiron të thërrasë zgjedhje të parakohshme, ose të përpiqet të krijojë një koalicion të ri. Vendimi për të dhënë dorëheqje

vjen pas një sulmi të ashpër ndaj partnerit të koalicionit dhe njëherësh ministër i Brendshëm, Matteo Salvini.

Conte tha se Salvini kishte qenë "i papërgjegjshëm" pasi krijoi një krizë të re politike për Italinë për "interesa personale dhe partiake". Salvini, udhëheqësi i partisë nacionaliste të Ligas, kishte ngritur një mocion mosbesimi kundër Conte. Ai tha se nuk mund të punonte më me partnerët e tij të koalicionit nga partia Pesë Yjet.

Lideri i partisë Pesë Yjet, Luigi di Maio, ka thënë se nuk dëshiron zgjedhje të reja, duke insistuar se reforma për parlament duhet të jetë në qendër të vëmendjes. Bazuar në sondazhe, partia e Salviniit gëzon dukshëm më shumë përkrahje, kryesisht për shkak të qasjes së tij kundër migrantëve. Në zgjedhjet e vitit të kaluar, Lëvizja Pesë Yjet ka fituar dy herë më shumë vota sesa Partia Liga, mirëpo sondazhet parashikojnë se gjendja tani është ndryshe.

Dështon formimi i qeverisë në Bosnjë e Hercegovinë

SARAJEVË, 20 GUSHT - Takimi në Sarajevë ndërmjet anëtarëve të Presidencës trepalëshe, Shefik Xhaferoviq, Zelko Komshiq dhe Milorad Dodik, përfundoi pa një marrëveshje për formimin e kabinetit të ri, sepse Dodiku ishte kundër një pakete që do ta përfshinte edhe miratimin e një plani që do ta

afronte Bosnjën drejt anëtarësimit në NATO.

Bosnja në vitin 2010 iu bashkua Planit të Veprimit për Anëtarësimin në NATO - një hap i parë drejt anëtarësimit përfundimtar në aleancë.

Në dhjetor të vitit 2018 ministrat e jashtëm të NATO-s u morën vesh ta aktivizojnë programin e

këshillave dhe asistencës së aleancës dhe ta paraqesin Planin e parë Vjetor Kombëtar. Sidoqoftë, Dodiku ka qenë përgjithmonë kundër hyrjes së Bosnjës në NATO, duke këmbëngulur për të ruajtur një status neutraliteti.

Mosmarrëveshjet midis serbëve pro-rusë të Bosnjës dhe dy

grupeve të tjera etnike mbi marrëdhëniet e ardhshme të Bosnjës me NATO-n mund ta zhysin vendin në një krizë më të thellë. Një marrëveshje midis përfaqësuesve të tri grupeve kryesore etnike serbe, kroate dhe boshnjake, është thelbësore, sepse mungesa e një qeverie ka shkaktuar ngecje në zhvillimin



ekonomik të vendit, që ende po përpiqet të rimëkëmbet pas luftës shkatërruese të viteve 1992-95.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

Ju mirëpret:

Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333

E jashtëzakonshme

Shishja me mesazhin 50-vjeçar të marinarit rus gjendet në brigjet e Alaskës

Një shishe e mbyllur me një letër të shkruar 50 vjet më parë u gjet në brigjet e Alaskës perëndimore. Shishja që përmbante një letër të shkruar me shkrim dore në rusisht u gjet nga Tyler Ivanoff në fillim të muajit, ndërsa po mblidhte dru zjarri afër Shishmaref, 966 kilometra në veriperëndim të Anchorage,



qyteti më i madh në Alaska sot. "Isha thjesht duke mbledhur dru dhe vura re një shishe jeshile me tapë. Jo saktësisht tapë, por një kapak i mbyllur fort dhe vura re që kishte një shënim në shishe", ka thënë Ivanovi.

FOTO E DITES



Valltarët e zjarrit performojnë gjatë Festivalit "Esala Perahera" pranë tempullit Budist të Dhëmbit në kryeqytetin antik të kodrës Kandy në Sri Lanka. /AFP/

E rrallë

Vodhën 40 kilogramë rërë në Sardenja, arrestohet çifti

Një çift francez, që u kapën me rreth 40 kilogramë rërë në makinën e tyre të marrë në Sardenja, mund të përballeshin me deri në gjashtë vjet burgim. Çifti francez akuzohen për vjedhjen e rërës. Ata thanë se donin ta çonin rërën në



shtëpi si një "suvenir" dhe nuk e dinin se kishin kryer vepër penale. Rëra e bardhë e famshme e Sardenjës konsiderohet një e mirë publike dhe është rreptësisht e ndaluar marrja e saj nga ishulli.

BARSOLETA E DITËS



Shkon djali te doktori sepse kishte disa shqetësime shëndetësore:
 - Doktori: Duhet të merresh me sport që të kesh shëndet më të mirë.
 - Djali: Po unë çdo ditë luaj futboll, basketboll, tenis...
 - Doktori: Sa orë në ditë luani?
 - Djali: Derisa t'i mbarojë bateria telefonit.




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Çdo ditë në ora 15:30
The Angry Birds Movie 2 (3D)

Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 39 min
 Rolet: Jason Sudeikis, Josh Gad, Leslie Jones, Bill Hader, Rachel Bloom, Danny McBride, Peter Dinklage, Nicki Minaj, etj.

Regjia: Thurop Van Orman



Në ora 17:30

GOOD BOYS

Aventurë/Komedi; 1 orë 29 min

Rolet: Jacob Tremblay, Keith L. Williams, Brady Noon, Molly Gordon, Lil Rel Howery, Will Forte, etj.

Regjia: Gene Stupnitsky




Çdo ditë në ora 19:15

"HOBBS & SHAW"

Aksion/Aventurë/Triller; 2 orë 15 min

Rolet: Dwayne Johnson, Jason Statham, Idris Elba, Vanessa Kirby, Helen Mirren, etj.

Regjia: David Leitch




Çdo natë në ora 21:30
ONCE UPON A TIME IN HOLLYWOOD

Komedi/Dramë; 2 orë 41 min

Rolet: Leonardo DiCaprio, Brad Pitt, Margot Robbie, Al Pacino, etj.

Regjia: Quentin Tarantino



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

 <p>DASHI Sot mos u mēzrisni nëse personat pranë jush nuk do t'ju thonë ato që doni të dēgjoni. Mē mirē t'ju thonē tē vērtetēn.</p>	 <p>DEMI Jeni pērqendruar nē njē pikē tē caktuar dhe do ta neglizhoni çdo gjē tjetēr rreth jush. Njē darkē romantike me partnerin do t'ju kēnaqē.</p>	 <p>BINJAKËT Shumē çēshtje mund t'i injoroni sot, por njēra nē veçanti ēshtë shumē e rēndēsishme pēr t'u lēnē mēnjani.</p>	 <p>GAFORRJA Sot mund tē ketē shumē keqkuptime qē lidhen me sjelljen tuaj hipersensibel dhe me emocionet e dukshme.</p>	 <p>LUANI Sot do tē kuptoni se pse persona tē caktuar kanë kohē qē janë larguar nga ju, kjo pēr shkak tē sjelljes suaj.</p>	 <p>VIRGJËRESHA Jeni pak nostalgjik sot pēr shkak edhe tē kohēs, por kujtimet e bukura do tē jenē tē vetmet qē ju vijnē nē mend.</p>
 <p>PESHORJA Nēse e nisni ditēn me kēmbēn e mbarē, sot do tē keni vetēm lajme tē bukura gjatē gjithē kohēs nē vazhdim.</p>	 <p>AKREPI Pēr tē vendosur tē ardhmen tuaj duhet t'i zgjidhni patjetēr problemet qē keni me tē tashmen qē s'po ju lēnē tē qetē.</p>	 <p>SHIGJETARI Jini mē i pranishēm nē jetēt e personave qē doni sepse do tē vijē çasti dhe nuk do ta gjeni mē vendin tuaj.</p>	 <p>BRICJAPI Sot jeni shumē pesimiste sepse keni parē qē bashkēpunētōrēt tuaj po pērpiqen ta zvogēlojnē sa ta mundin punēn qē ju bēni.</p>	 <p>UJORI Keni njē situatē kompromentuese qē mund t'ju shqetēsōjē sot, por nēse veproni me natyralitet, çdo gjē do tē zgjidhet mē sē miri.</p>	 <p>PESHQIT Edhe durimi juaj e ka njē limit, por kjo gjē nuk po kuptohet akoma mirē nga ata qē ju qēndrojnē pranē.</p>

Ariana Grande shijon rikthimin magjik në Britani



Ariana Grande mahniti fansat dhe kritikët gjatë koncertit të vet të parë të plotë në Mbretërinë e Bashkuar që nga sulmi në Manchester, në O2 Arena të Londrës. Këngëtarja amerikane ka performuar një

seri prej 24 këngësh të kompletuara me ndriçim neoni dhe një rikrijim të darkës së fundit. "Faleminderit për natën magjike të hapjes!", ka shkruar Grande në llogarinë e vet në "Twitter".

"tWitch" do të bëhet babai i një vajze



Valltari dhe aktori Stephen "tWitch" Boss dhe gruaja e tij Allison Holker do të bëhen prindër të një vajze të vogël. Këtë lajm e ka bërë me dije vetë Holkeri me anë të një postimi në rrjetin social

"Instagram". Ajo ka thënë se nuk mund t'i shprehin emocionet e tanishme që kanë bashkë me burrin. "Ne i falënderojmë shumë miqtë dhe familjarët tanë për dashurinë që treguan ndaj nesh", ka shkruar Holker.




Martohet Dwayne Johnson

Aktori i njohur Dwayne Douglas Johnson është martuar të hënën me të dashurën e vet Lauren Hashian. Lajmin e ka bërë me dije "The Rock" me anë të një postimi në rrjetin social "Instagram". Çifti kishin një martesë private në

qytetin e Havait. "Ne e bëmë më 18 gusht të 2019-s, Havai, jemi të bekuar", ka shkruar aktori në fotografit e publikuara në "Instagram". Këngëtarja Lauren u takua me Dwayne në vitin 2006, derisa po filmonte filmin "The Game Plan".

A do të martohen edhe një herë Justin Bieber dhe Hailey Baldwin?



Këngëtarja Justin Bieber dhe modeluesja Hailey Baldwin janë kurorëzuar në një ceremoni private vitin e kaluar. Çifti ka vendosur të bëjë një dasmë për miqtë dhe familjarët dhe për veten. Këtë e ka bërë me dije për "TMZ" një

burim i afërt me çiftin, duke thënë se ata do ta bëjnë dasmën më 15 shtator të këtij viti, ku i bie të jetë edhe përvjetori i martesës së tyre private. Bieber dhe Baldwin janë të dashuruar marrëzisht. Ata të hënën u kthyen nga pushimet.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport

QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

Zabergja: Do të shënoj shumë gola

Enis Zabergja, pavarësisht prej moshës që ka, ka shprehur optimizëm se golat që do t'i shënoj në këtë kampionat do të jenë të shumtë. "Normalisht se jam shumë i lumtur, por dua të them se jam përgatitur mirë fizikisht dhe kur nuk më mungon përgatitja, atëherë shënimin e golave e kam të lehtë", ka thënë Zabergja, i cili së bashku me Kastriot Rexhën dhe Adrian Mujën kanë shënuar nga dy gola



EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 20 GUSHT - Skuadra e Llapit e nisi kampionatin e ri në IPKO Superligën e Kosovës me fitore dhe më meritori për këtë ishte Enis Zabergja, i cili i shënoi dy prej katër golave në ndeshjen ndaj Vushtrrisë (4-1). Llapi ishte duke humbur 0-1, por dy golat e sulmuesit Zabergja i dhanë epërsinë skuadrës që drejtohet nga Tahir Batatina, kurse më pas shënuan edhe dy gola të tjerë.

Të martën Enis Zabergja për gazetë është shprehur i lumtur që ka arritur ta ndihmojë skuadrën në suksesin e parë të edicionit 2019/2020. "Jam i lumtur që arrita ta ndihmoj skuadrën ta

shënoj fitoren e parë në kampionat. Kemi një grup të mirë të lojtarëve dhe në vazhdimësi mund të marrim rezultat pozitiv, por edhe për mua është më e lehtë të paraqitem mirë dhe të shënoj gola", ka deklaruar Zabergja. Sulmuesi këmbëshpejtë, pas një kampionati të kaluar në Ligën e Parë, është rikthyer fuqishëm në Superligë, duke shënuar dy gola vetëm në një ndeshje. Zabergja ka konfirmuar se është përgatitur maksimalisht dhe forma e tij nuk është befasi, kurse në lidhje me golat që do të shënoj është shprehur i matur, duke thënë se primare i ka rezultatet e klubit. "Normalisht se jam shumë i lumtur, por tash jam mirë fizikisht dhe kur nuk më mungon për-

gatitja fizike, shënimin e golave e kam të lehtë. Nuk kam ndonjë synim personal, pasi në rend të parë janë rezultatet e klubit. Do të përpiqem që në çdo ndeshje ta jap kontributin për t'i arritur objektivat e klubit", ka thënë Zabergja, i cili së bashku me Kastriot Rexhën e Feronikelit dhe Adrian Mujën e Trepçës '89 kanë realizuar nga dy gola në xhiron e parë.

34-vjeçari Enis Zabergja është një nga lojtarët më të mirë në vitet e fundit në futbollin e Kosovës, kurse më herët ka luajtur edhe për Trepçën, Hysin, Hajvalinë, 2 Korrikun, KEK-un, Drenicën. Ka qenë pjesë edhe e përfaqësueses para se futbollit i Kosovës të pranohet në UEFA dhe FIFA.

SHKURT

Shtyhet ndeshja Prishtina - Dukagjini

Ndeshja e javës së dytë në IPKO Superligën e Kosovës në futboll, Prishtina - Dukagjini, e paraparë të zhvillohet në këtë fundjavë, është anuluar nga Komisioni i Garave i Federatës së Futbollit të Kosovës për shkak të ruajtjes së fushës për ndeshjen kualifikuese në Kampionatin Evropian, Kosovë - Çeki. "Ndeshja nuk është caktuar kur do të luhet, por si datë e mundshme është dita e mërkurë, 25 shtator", thuhet në njoftimin e FC Prishtina. Ndeshjen e radhës skuadra nga kryeqyteti e zhvillon ndaj Feronikelit pas dhjetë ditësh në Drenas.

Komuna e Mitrovicës shpërblen me 2 000 euro Muhamet Ramadanin

Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, sot ka prituri në një takim talentin e atletikës, Muhamet Ramadanin, i cili ishte i shoqëruar me trajnerët Klubi i Atletikës "Mitrovica", Xhavit Tahiri dhe Shaban Ramadani. "Kryetari Bahtiri dhe trajneri Ramadani u morën vesh që Komuna e Mitrovicës ta ndërtojë një minifushë sipas normave ndërkombëtare për hedhje të gjyës, pasi stadiumi 'Adem Jashari' është në renovim. Kjo fushë do të ndërtohet afër Liqenit Akumulues në fshatin Suhodoll. Kryetari Bahtiri ofroi mbështetjen e tij, duke ndihmuar talentin mitrovicës me rreth 2 000 euro për sukseset e treguara në arenën ndërkombëtare", thuhet në njoftimin e Komunës së Mitrovicës.

Adgeri përforcon Yllin

KB Golden Eagle Ylli është përforcuar me Anthony Adgerin. Ai ka thënë se është shumë i emocionuar se do ta bartë fanellën e skuadrës nga Suhareka. "Jam shumë i emocionuar që do të jem pjesë e Golden Eagle Yllit dhe tashmë mezi po pres të vij dhe t'i fillojmë stërvitjet. Po pres të kem përvojë interesante këtë vit në Kosovë dhe të shoqërohem me bashkëlojtarët për një lojë të fortë", ka thënë Adger.

Rashica mungon dhjetë ditë

Milot Rashica pritet të mungojë dhjetë ditë si pasojë e lëndimit të pësuar në ndeshjen e parë në Bundesliga. Lajmi konfirmohet nga gazeta gjermane "Bild". Ylli i reprezentacionit të Kosovës u zëvendësua në pjesën e dytë ndaj Fortuna Dusseldorfit. "Miloti ka pësuar një lëndim në muskul. Se çfarë saktësisht ka Miloti, ne duhet t'i presim ekzaminimet mjekësore", ka thënë Frank Baumanit, drejtor sportiv i Werder Bremenit. Lajmi i mirë për Kosovën është se Rashica do të jetë i gatshëm për dy ndeshjet e muajit shtator ndaj Çekisë dhe Anglisë.

Muriqi: Pres shumë pasime nga Emre

Vedat Muriqi e nisi në mënyrën më të mirë të mundshme aventurën me skuadrën e Fenerbahçes. Ish-futbollisti i Teutës dhe Besës së Kavajës në Shqipëri debutoi zyrtarisht me gol në ndeshjen e parë të kampionatit kundër Gaziantepit teksa skuadra e tij triumfoi me rezultatit e thellë 5-0. Në minutën e 17-të, pas një asistimi fantastik të Emres, shqiptari i Kosovës pranoi topin me gjoks dhe me një goditje me këmbë tundi rrjetën, duke dyfishuar rezultatin. "Jam shumë i lumtur me fitoren sepse ishte shumë e rëndësishme për ne. Edhe pse kundërshtari ndoshta nuk ka qenë shumë i fortë, për tifozët tani ishte me rëndësi të shijonin një natë kaq të bukur. E njoh mirë Emrenë. Ai bëri një pasim shumë të mirë dhe shpresoj se do të kem më shumë topa të tillë në ndeshjet e ardhshme", ka deklaruar Muriqi.

San Antonio tërheq fanellën me numër 9

SAN ANTONIO, 20 GUSHT - Skuadra e San Antonio Spursit ka marrë vendimin për ta tërhequr fanellën me numër 9, të cilën e mbante basketbolisti francez Tony Parker. 37-

vjeçari u tërhoq në fund të sezonit të kaluar. Ceremonia do të kryhet më 11 nëntor. Me fanellën e "Spurs"-it ai fitoi 4 tituj kampionë, duke qenë një nga ikonat e këtij ekipi dhe të

NBA-së. Një herë është shpallur MVP i finaleve dhe 6 herë ka luajtur në "All Star Game". San Antonio merr këtë vendim për ta vlerësuar e respektuar, ashtu sikurse ka bërë më parë

edhe me dy ish-shokët e tij të skuadrës: Manu Ginobili dhe Tim Duncan. Tony Parker është basketbollisti i dhjetë që skuadra e "Spurs"-it i tërheq fanellën.



Federata e Futbollit, 10 mijë euro për KFF Mitrovica

PRISHTINË, 20 GUSHT - Suksesi i arritur nga KFF Mitrovica në fazën e parë të Ligës së Kampionëve është mirëpritur kudo në Kosovë dhe është vlerësuar si një hap para në zhvillimin e mëtutjeshëm të futbollit të femrave. Për t'i përgëzuar për suksesin e arritur, të martën në selinë e FFK-së është organizuar një pritje për futbollistet dhe stafin e KFF Mitrovica, ku ishin të pranishëm kryetari Agim Ademi, nënkryetari Bakir Burri, kryetarja e komisionit të femrave, njëherësh anëtarja e KE-s, Vjollcë Krasniqi, anëtari i KE-s, Bekim Rexhepi dhe menaxherja e futbollit të femrave, Valbona Gashi-Uka. Me këtë rast, presidenti Ademi ka uruar futbollistet e Mitrovicës dhe stafin e klubit për paraqitjen dinjitoze në fazën e parë të 'Champions'-it dhe për kalimin në mesin e 32 ekipeve më të mira të Evropës. "Ky është një sukses deri tash i paarrtshëm te ne dhe jam shumë i lumtur për këtë arritje tuajën. Personalisht e kam edhe një arsye më shumë për t'u gëzuar, ngase shumë prej jush keni qenë pjesë e klubit tim dhe jeni rritur aty. Gjithsesi uroj trajnerët për punën e bërë, sepse janë ata që e koordinojnë ekipin, derisa kur kryesia është e organizuar si në klubin tuaj, atëherë s'do mend se suksesi nuk mungon. Ky sukses i juaji njëherësh demanton atë thënien e mëparshme që ne mund të arrijmë suksese vetëm në aspektin individ-



ual, pasi tashmë kemi filluar të arrijmë suksese të njëpasnjëshme edhe si kolektiv. Futbollit është sport kolektiv dhe ju keni treguar se me punë dhe angazhim mund të arrihet suksesi", ka thënë Ademi. Ai ka thënë se tani është e rëndësishme të krijohet mentaliteti i fituesit sepse nuk ka asgjë që nuk mund të arrihet kur ka angazhim dhe vullnet për punë. Ai ka uruar që edhe në ndeshjen e ardhshme kundër një rivali tepër të fortë si Wolfsburgu vashat e Mitrovicës të tregojnë kualitet dhe të befasojnë për të mirë, pasi nganjëherë dëshira, motivi dhe vullneti mund ta mposhtin kualitetin. Për këtë arritje presidenti Ademi ka thënë se është marrë vendim për ta shpërblyer klubin kampion me 10 mijë euro. "Kjo nuk është shifra çfarë kam dëshirë t'ju shpërblej por, thjesht, ajo çfarë kemi mundësi. Këtë

shpërblim kemi vendosur t'ju japim në shenjë të këtij suksesi, por sigurisht se mbështetja për futbollin e femrave do të mbetet ndër prioritetet tona", ka shtuar Ademi. Ndërkaq kryetarja e komisionit të futbollit të femrave, Vjollcë Krasniqi, ka deklaruar: "Ky sukses na ka dhënë emocion jo vetëm neve që jemi në drejtim të FFK-së, por edhe mbarë opinionit futboll-dashës. Prandaj, uroj të keni suksese të tjera dhe besoj në paraqitje të mira edhe kundër skuadrës gjermane". Ndërsa në emër të KFF Mitrovica drejtuesit e FFK-së i falënderoi kryetari i klubit, Hajrullah Haxhiu, i cili theksoi se edhe më herët e kanë pasur përkrahjen e plotë të FFK-së dhe se tani kur janë në mesin e 32 ekipeve më të mira të Evropës, kanë nevojë edhe për mbështetje organizative të ndeshjeve.

10 huazimet më të shtrenjta në histori të futbollit



MUNCHEN, 20 GUSHT - Philippe Coutinho ishte ylli i fundit në radhë që u huazua për një shumë të majme nga Barcelona te Bayern Muncheni. Një praktikë që po shtohet mes klubeve të futbollit në kohë merkatoje, kur milionat nuk mjaftojnë për të bërë blerje përfundimtare. Sidoqoftë, në shumicën e kësaj rruge të ndjekur është lënë "litari jashtë", çka do të thotë se pala e interesuar ka pasur mundësinë e blerjes së lojtarit përkatës në fund të kohës së huazimit. Nuk ka funksionuar disa herë kjo skemë. Mjafton t'i kujtojmë dy huazimet e Higuainit (Milanit dhe Chelseas), James Rodriguezit (Bayern Munchenit).

LISTA E LOJTARËVE TË HUAZUAR

- | | |
|-----------------------|---|
| 1. Kylian Mbappe | (Monaco-PSG, 45 milionë euro) |
| 2. Giovanni Lo Celso | (Betis-Tottenham, 16 milionë euro) |
| 3. Duvan Zapata | (Sampdoria-Atalanta, 14 milionë euro) |
| 4. James Rodriguez | (Real M.-Bayern M., 13 milionë euro) |
| 5. Carlos Tevez | (West Ham-M.United, 12.7 milionë euro) |
| 6. Nicolo Barella | (Cagliari-Interi, 12 milionë euro) |
| 7. Mattia Destro | (Genova-Roma, 11.5 milionë euro) |
| 8. Gonzalo Higuain | (Milani-Juventus, 9 milionë euro) |
| 9. Gonzalo Higuain | (Chelsea-Juventus, 9 milionë euro) |
| 10. Philippe Coutinho | (Barcelona-Bayern M., 8.5 milionë euro) |

SHKURT

Rama transferohet në Gjermani

Valdet Rama ka nisur zyrtarisht aventurën e re në kampionatin gjerman, duke u transferuar në ligën e tretë. Ish-sulmuesi i kombëtares që ishte pjesë e Kukësit nuk ka pranuar ta rinovojë kontratën me Kukësin, duke u rikthyer në Gjermani, aty ku ka edhe familjen. "Meppen forcohet në sulm me Valdet Ramën, një ëndërr e madhe e trajnerit Kristian Neidhart për shumë kohë. 31-vjeçari ka firmosur kontratë dyvjeçare me opsionin rinovimit në bazë të paraqitjeve të bëra. Ai mund të kishte firmosur më herët, por kishte kontratë me Kukësin deri në përfundim të Kupave të Evropës", thuhet në njoftimin e klubit gjerman.

Hazardi debuton ndaj Villarrealit

Përforcimi kryesor i Real Madridit, Eden Hazard, pritet ta bëjë debutimin në La Liga më 1 shtator, kur Real luan si mysafir i Villarrealit. Futbollisti belg me shumë bujë është transferuar nga Chelsea, kurse e humbi ndeshjen e parë në La Liga ndaj Celta Vigos për shkak të lëndimit që pësoi në stërvitje para ndeshjes ndaj Vigos. Anëtori mungon edhe në ndeshjen e dytë më 24 gusht ndaj Valladolidit.

Zappacosta huazohet në Romë

Davide Zappacosta është larguar nga Chelsea dhe i është bashkuar Romës në formë huazimi. Zappacosta në vitin 2017 iu bashkua Chelseat, por nuk ishte titullar në edicionin e kaluar. Ai nuk ishte në planet e trajnerit Frank Lampard dhe vendosi të largohet nga Londra.

Alonso refuzon ofertën e Red Bullit

Red Bull i ka bërë një ofertë Fernando Alonso për ta pilotuar makinën austriake në pjesën e dytë të këtij sezoni, por piloti spanjoll ka refuzuar. Sipas "Mundo Deportivo", para se Red Bulli ta bënte shkëmbimin në mes të Pierre Gasly dhe Alexander Albon mendoi të sillte një ikonë të garave të Formulës 1. Gjithsesi, Alonso ka refuzuar ta pilotojë makinën austriake, duke iu përgjigjur me një "jo" kësaj oferte. Mësohet se Alonso nuk ka preferuar për dy arsye: Nuk dëshiron të ulej në ulësen e një makine në mesin e sezonit dhe nuk dëshiron të kishte si shok skuadri Max Verstappen. "I kam idetë e qarta për të ardhmen dhe nuk pres të më kërkojë njeri në mes të sezonit. Kam qenë unë ai që ka zgjedhur gjithnjë ku dhe kur do të garoj dhe këtë vendim e marr vetëm për të mirën time", u shpreh Alonso, që pritet të garojë në Rally Dakar.

Camacho: Messi nuk mund të jetë lojtari më i mirë pa fituar Kupën e Botës

Lionel Messi nuk mund të konsiderohet më i madhi i të gjitha kohëve si një argjentinas pa fituar Kupën e Botës, thotë ish-trajneri i Real Madridit dhe Spanjës, Jose Antonio Camacho. Për shumë njerëz, talenti i Barcelonës është futbollisti më i mirë në të gjithë historinë e futbollit. Është e vështirë të argumentosh kundër kësaj duke pasur parasysh të gjitha ato që pesë herë fituesi i Topit të Artë ka arritur gjatë një karriere të shquar. "Ai është një lojtar shumë i mirë, por nuk mund të jesh më i miri në botë, e lëre më në histori, nëse je argjentinas dhe nuk fiton një Kupë të Botës", ka thënë Camacho. "Ka vende me traditë më të vogël që kur të mos fitosh Kupën e Botës është më pak e rëndësishme, por Argjentina është një forcë mbizotëruese. Jo, pa një Kupë Botërore, Messi nuk mund të jetë më i miri", ka shtuar Camacho.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
 Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije
 Ministri of Education, Science and Technology

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji nr.03/ L -149, neni 12, paragrafi 4, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë shpall:

Konkurs për "Marrëveshje për shërbime të veçanta"

Institucioni: Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë

Departamenti: I arsimit parauniversitar
Paga bruto: 423.47 €

Titulli i vendit të punës: Dy zyrtar për tekste shkollore (2 vende pune)

Kohëzgjatja e kontratës: 6 muaj

Vendi i punës: Prishtinë **Datë:** 20.08.2019

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Harton dhe zhvillon planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njësisë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre objektivave;
- Analizon legjislacionin, politikat dhe procedurat lidhur me zhvillimin e arsimit parauniversitar dhe zhvillimin e planprogrameve dhe teksteve shkollore dhe rekomandon përmirësime;
- Harton, zhvillon dhe mbikëqyrë zbatimin legjislacionit, politikave, standardeve për zhvillimin e arsimit parauniversitar dhe planprogrameve dhe sigurimin e teksteve shkollore;
- Identifikon, dhe ndërlihdë zhvilluesit dhe prodhuesit e teksteve shkollore dhe të materialeve (burimeve) të tjera në harmoni me nevojat e kurrikulit të ri dhe monitoron punën e tyre;
- Këshillon zhvilluesit e materialeve (burimeve) dhe të teksteve shkollore dhe siguron të drejtën e autorit dhe kërkesat e tjera ligjore që janë të mbështetura dhe të mbrojtura me ligj;
- Përgatitë materiale të nevojshme për zhvilluesit e teksteve dhe burimeve dhe ofron materiale relevante për Këshillin e planprogrameve dhe të teksteve shkollore.
- Sigurojnë mbështetje administrative për Këshillin e Kurrikulit lidhur me përgatitjen e teksteve shkollore për arsimin paruniversitar;
- Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;

Kualifikimet

- Diploma universitare (profil arsimor) minimum 2 vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri dhe përvojë në fushën e arsimit;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme lidhur me arsimin;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për përmbyshje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Internetit).

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, të kenë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe aftësitë fizike që kërkojnë për pozitën përkatëse.

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi mbetet i hapur 6 ditë kalendarike nga dita e publikimit në uebfaqen e MASHT-it dhe shtypin ditor. Data e mbylljes së konkursit 26.08.2019.

Kandidatët aplikacionin (formularin për konkurrim) mund ta tërheqin në web faqen e MASHT-it <http://masht.rks-gov.net/>, ose ta marrin në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Rr. "Agim Ramadani" nr. 1 në zyrën e arkivit ku edhe i dorëzojnë aplikacionet e plotësuar.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten: Kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, si dhe dokumentacione tjera të nevojshme sipas konkursit.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen

U skladu sa odredbama Zakona o Civilnim Službenicima Republike Kosova, Zakon br. 03/ / L-149, član 12, stav 4, Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i tehnologije objavljuje:

Konkurs za "Sporazum o posebnim uslugama"

Institucija: Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije

Departament: Preduniverzitetno obrazovanje

Bruto plata: 423.47 €

Naziv radnog mesta: Dva zvaničnika za školske udžbenike (2 radna mesta)

Vreme trajanja ugovora: 6 meseci

Radno mesto: Priština

Datum: 20.08.2019

Zadaci i odgovornosti:

- Izrađuje i razvija planove rada u skladu sa nadzornikom za sprovođenje dodeljenih zadataka na osnovu ciljeva i daje preporuke oko postizanja ovih ciljeva;
- Analizira zakonodavstvo, politike i procedure vezane za razvoj preduniverzitetskog obrazovanja i razvoja nastavnog plana i školskih udžbenika i preporučuje poboljšanja;
- Izrađuje nacрте, razvija i nadgleda sprovođenje zakona, politika, standarda za razvoj preduniverzitetskog obrazovanja i nastavnih planova i programa i obezbeđivanje školskih udžbenika;
- Identifikuje i povezuje programere i proizvođače školskih udžbenika i ostalog materijala u skladu sa potrebama novog nastavnog programa i nadgleda njihov rad;
- Savetuje programere materijala(izvora) i školskih udžbenika i obezbeđuje autorska prava i druge zakonske zahteve koji su zakonski podržani i zaštićeni;
- Priprema potrebne materijale za programere udžbenika i resursa i pruža relevantne materijale savetu za nastavne planove i školskih udžbenika;
- Pruže administrativnu podršku savetu za nastavne programe vezano sa pripremom školskih udžbenika za preuniverzitetno obrazovanje;
- Obavlja ostale zadatke u skladu sa zakonima i propisima koji mogu biti povremeno zahtevani od strane nadzornika;

Kvalifikacije

- Univerzitetska diploma (profil obrazovanja) najmanje 2 godine profesionalnog radnog iskustva;
- Znanje i iskustvo u oblasti obrazovanja;
- Poznavanja važećih zakona i propisa koji se tiču obrazovanja;
- Veštine u komunikaciji, planiranju rada i vođenju tima;
- Istraživačke, analitičke i veštine za procenjivanje i formulisanje preporuki i profesionalnih saveta;
- Sposobnost obavljanja zadataka i rada pod pritiskom;
- Sposobnost rada na kompjuteru aplikativnih programa (Word, Excel, Power Point, Access, Internetit).

Uslove učešća na konkurs:

Pravo učešća ma konkurs imaju svi odrasli građani Republike Kosova koji imaju punu sposobnost za rad i delovanje, da imaju potrebnu obrazovnu kvalifikaciju i profesionalnu sposobnost za obavljanje dužnosti i fizičkih sposobnosti potrebnih za odgovarajući položaj.

Datum zatvaranja konkursa: Konkurs ostaje otvoren 6 kalendarskih dana od dana objavljivanja na web stranici MONT i dnevnoj štampi. Dan zatvaranja konkursa je 26.08.2019.

Kandidati obrazac za prijavu mogu povući na web stranici MONT <http://masht.rks-gov.net/>, ose ili da uzimaju u Ministarstvu Obrazovanja, Nauke i Tehnologije, Ul. "Agim Ramadani" br. 1 gde takođe ostavljaju popunjene prijavke.

Prijavi treba priložiti: Kopiju lične karte, kopije dokumentacija o kvalifikaciji, i ostala potrebna dokumenta u skladu sa konkursom.

Zahtevi poslati posle zadnjeg datuma neće biti prihvaćeni. Zbog velikog broja prihvaćenih zahteva, samo određeni kandidati u užem izobru biće kontaktirani.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
ZYRA E KRYEMINISTRIT/ OFFICE OF THE PRIME MINISTER/ URED PREMIJERA
AGJENCIA PËR BARAZI GJINORË / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA/
AGENCY OF GENDER EQUALITY

Njoftim për ndarje të subvencioneve për individ fizik

Me qëllim të zbatimit të Ligjit për Barazi Gjinore, Programit të Kosovës për Barazi Gjinore, Udhëzimit Administrativ Nr 01/02/2012 për Subvencionimin e Projekteve nga Fusha e Barazisë Gjinore si dhe mandatin të saj, Agjencia për Barazi Gjinore njofton të gjithë të interesuarit se do të bëjë subvencionimin e pjesërishëm të projekteve të cilat promovojnë barazinë gjinore, pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje, dhe fuqizimin ekonomik të tyre.
Të drejtë aplikimi kanë personat fizik të cilët janë aktiv në fushën e barazisë gjinore.

Kriteret e pranimit

Në mënyrë që projekti të jetë i pranueshëm duhet të trajtojë një apo më shumë nga fushat e mëposhtme:

- Të ndikojë në fuqizimin ekonomik të grave të cilat janë duke zhvilluar aktivitete në fushën e: (Bujqësisë, blegtorisë, agrikulturës, artizanateve, trashëgimisë kulturore etj).
- Të ndikojë në ndërgjegjësim kundër dhunës në familje, dhunës ndaj grave;
- Të ndikoj në fuqizimin ekonomik të grave viktimave të dhunës në familje;
- Të ndikojë në ndërgjegjësimin rreth çështjes së viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë;
- Të promovojë zhvillimin e turizmit rural nën drejtimin e grave/vajzave;
- Të mbështes zhvillimin e gjithanshëm dhe përmirësimin e pozitës së grave në vendimmarrje ekonomike, dhe/ apo fusha të tjera.

Projekt propozimi duhet të përmbajë:

- Përshkrim të detajuar të aktiviteteve të parapara kushteve dhe kriterëve brenda të cilit duhet të realizohet, personat e angazhuar, mekanizmat e zbatimit, monitorimin, vlerësimin e ndikimit të masave të zbatuara dhe të jetë transparent;
- Plan të realizimit të aktiviteteve (Plani dinamik);
- Tabelën financiare;

Dokumentacioni i nevojshëm

Aplikuesi/ja, duhet të sigurojë dokumentet bashkë me projekt-propozimin, si në vijim:

1. Formulari i aplikimit (mund të shkarkohet nga faqja e ABGJ, <http://abgj.rks-gov.net/sq-al/leftlinksal/shpalljenjoftime.aspx>)
2. Kopjen e letërnjoftimit për personat fizik.
3. Referenca të projekteve të mëparshme (Nëse ka).
4. Kopjen e kartelës bankare valide për llogarinë rrjedhëse;
5. Vërtetimin bankar për autorizim mbi llogarinë rrjedhëse;
6. Certifikatën e Gjykatës që nuk është nën hetim.

Projektet për subvencionim do të përzgjidhen nga komisioni i formuar nga Agjencia për Barazi Gjinore, në bazë të nenit 11, të Udhëzimit Administrativ 01/2012, për Subvencionimin e Projekteve nga Fusha e Barazisë Gjinore.

Personat juridik apo fizik, përfutues të subvencioneve, duhet të përfundojnë implementimin e projekteve të propozuara deri me /apo para datës 30 Nëntor 2019.

Vërejtje: Rimbursimi i përfutuesve bëhet pas përfundimit të secilës fazë të paraparë në projekt, si dhe pas dorëzimit të faturave origjinale, kuponave fiskal dhe/ apo faturave të tjera të parapara në Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike 03/L-048.

Përfutuesit e mëhershëm të subvencioneve nga ABGJ-ja, nuk kanë të drejtë të përfitojnë dy herë radhazi subvencione nga ky institucion.

Inkurajojmë gratë kryefamiljare, minoritare, gratë përfutuese të asistencës sociale, që të aplikojnë për përfitim të subvencioneve (të vërtetohet me anë të dokumentacionit përkatës).

Data e nënshkrimit të marrëveshjes pas përzgjedhjes, për të gjithë përfutuesit, do të shpallet në ueb faqet e ABGJ-së.

Afati i aplikimit për subvencionimin e projekteve është 15 ditë kalendarike nga shpallja e njoftimit, nga data 21.08.2019 deri me 03.09.2019. Projektet duhet të dorëzohen në Agjencinë për Barazi Gjinore, Ndërtesa e Qeverisë - Sheshi Skënderbe, kati i VII Zyra 711.

Për informacione shtesë:

Personi kontaktues: Yllka Kotorri
Adresa Elektronike: yllka.kotorri@rks-gov.net
Tel: 038 200 14 274

Dokumentet e pakompletuara nuk do të pranohen.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
ZYRA E KRYEMINISTRIT/ OFFICE OF THE PRIME MINISTER/ URED PREMIJERA
AGJENCIA PËR BARAZI GJINORË / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA/
AGENCY OF GENDER EQUALITY

Obaveštenje o dodeljivanju subvencija

Sa ciljem sprovođenja Zakona o ravnopravnosti polova, Kosovski program za ravnopravnost polova, i Administrativno uputstvo br. 01/02/2012 o subvenciji projekata iz oblasti ravnopravnosti polova kao i svog mandata- Agencija za ravnopravnost polova obaveštava sve zainteresovane da će se vršiti delimična subvencija projekata koji promovisu ravnopravnost polova, učešće žena u donošenju odluka kao i njihovo ekonomsko osnaživanje.
Pravo na apliciranje imaju sva fizička lica i pravna lica koja su aktivna u oblasti ravnopravnosti polova.

Kriterijumi za odobranja

Sa ciljem da projekat bude odobren mora da tretira jednu ili više od dole navedenih oblasti:

- Da utiče na ekonomsko osnaživanje žena (npr. u poljoprivredi, stočarstvu, ručnom radu itd.);
- Da utiče na podizanje svesti protiv porodičnog nasilja/ nasilja nad ženama;
- Da ima uticaj na ekonomskom osnaženju žena, žrtve porodičnog nasilja;
- Da utiče na podizanje svesti oko pitanja žrtava seksualnog nasilja tokom rata na Kosovu;
- Da promovise razvijanje seoskog turizma pod upravom žena/ devojaka;
- Da podržava celokupni razvoj i poboljšanje položaja žena u donošenju odluka u ekonomiji, i/ili drugim oblastima.

Predlog projekta mora da sadrži:

- Detaljni opis predviđenih aktivnosti, uslova i kriterijuma u okviru kojih treba da se realizuje, angažovanih lica, mehanizama za sprovođenje, praćenja, procene uticaja sprovedenih mera i da bude transparentan
- Plan za realizaciju aktivnosti (Dinamični plan)
- Finansijsku tabelu.

Potrebna dokumentacija

Aplikant, mora da obezbedi dokumentaciju zajedno sa predlog projektom, na sledeći način:

1. Obrazac za aplikaciju (može da se preuzima sa internet stranice ARP-a, <http://abgj.rks-gov.net/sq-al/leftlinksal/shpalljenjoftime.aspx>)
2. Kopiju lične karte za fizička lica.
3. Reference iz prethodnih projekata (ako ih ima).
4. Kopija važećih bankarskih kartica za tekući račun
5. Potvrda ovlašćenja za tekući račun od banke.
6. Uverenje od suda da nije pod istragom.

Projektet za subvenciju će biti selektirani od strane komisije formirane od Agencije za ravnopravnost polova, na osnovu člana 11 Administrativnog uputstva 01/2012, za subvenciju projekata iz oblasti ravnopravnosti polova.

Pravna ili fizička lica, korisnici subvencija, moraju da završe sprovođenje predloženih projekata do/ili pre 30 Novembra 2019.

Pažnja: Nadoknadanja za korisnike se vrši nakon svake faze koja je predviđena u projektu i nakon predavanja originalnih racuna, fiskalnih kupona i drugih racuna koja predviđaju sa zakonom za vođenje javnih finansija 03/L-048.
Bivši primaoci subvencija od ARP-a, nemaju pravo da koriste dva puta iz ove ustanove subvencija.

Ohrabrujemo žene koje su glava porodice, žene iz manjina, žene korisnice socijalne pomoći, da apliciraju za korišćenje subvencija (to potvrditi sa odgovarajućom dokumentacijom).

Datum za potpisivanje ugovora nakon selekcije, za sve korisnike, će se objaviti na internet stranici ARP-a.

Rok za podnošenje aplikacija za subvenciju projekata je 15 kalendariskih radnih dana nakon objavljivanja obaveštenja, od 21.08.2019 do 03.09.2019. Projektet mora da se dostave kod Agencije za ravnopravnost polova, Zgrada Vlade- Trg Skanderbega, VII sprat, kancelarija br. 711.

Za dodatne informacije:

Za kontakte: Yllka Kotorri
Elektronska adresa: yllka.kotorri@rks-gov.net
Tel: 038 200 14 274

Nepotpuni dokumenti neće se primati.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJIS
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRIUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 308/1
Dt: 20.08.2019

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 4, Ligjit të Punës nr 03/L-212, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Neni 13 dhe 34, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012, Udhëzimit Administrativ Nr. 10/2018, Udhëzimit Administrativ 07/2017, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2015 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira në Qendrën e Kompetencës në Ferizaj dhe Skenderaj për vitin shkollor 2019/2020

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i ilirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
SHML	Qendra e Kompetencës	Ferizaj	Një (1) mësimdhënës/e për lëndën e matematikës me 14 orë mësimore;	Vend i lirë
			Një (1) mësimdhënës/e për lëndën e matematikës me 14 orë mësimore;	Vend i lirë
			Një (1) mësimdhënës/e për lëndën e Mikrobiologjisë me 10 orë mësimore;	Vend i lirë
SHML	Qendra e Kompetencës	Skenderaj	Një (1) mësimdhënës për lëndën e matematikës me (20 orë mësimore);	Zëvendësim deri në kthimin nga pushimi i lehonisë
			Një (1) punëtor teknik	Vend i lirë
			Një (1) Instruktor në drejtimin e Ndërtimitarisë, profili arsimor: Ngjyrë punues, llak punues (16 orë praktikë profesionale dhe 6 orë teori profesionale).	Vend i lirë

Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë plan programin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e plan programit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillt me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrë të duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet për gatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën trysni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;
- Në mungesë të kandidatëve të kualifikuar pranohen dhe kandidatët me kualifikime të përafërt në afat të caktuar.

Detyrat dhe Përgjegjësitë për Instruktor;

- Instruktori është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e praktikës profesionale.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të praktikës profesionale dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për instruktor:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 6 sipas KKK;
- Instruktor profesional me kualifikim: post sekondar, arsim të mesëm të lart;
- Të ketë më së paku 5 vjet përvojë punë në profesion në ndërmarrje biznese dhe institucione tjera;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet për gatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën trysni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;
- Në mungesë të kandidatëve të kualifikuar pranohen dhe kandidatët me kualifikime të përafërt në afat të caktuar.

Detyrat dhe Përgjegjësitë kryesore për pozitën punëtor teknik

- Bën mirëmbajtjen e pastërtisë së gjithë objektit;
- Ndihmon stafin për rregullimin e orendive të shkollës;
- Ndihmon menaxhmentin/personelin mësimdhënës të shkollës për realizimin e punëve teknike;
- Kujdeset për mirëmbajtjen e infrastrukturës shkollore.
- Merr pjesë në rregullimin e hapësirave të jashtme shkollore, si dhe detyra shtese të cilat i ndan drejtori i shkollës.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Kandidati duhet të ketë Shkollën e mesme,
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën trysni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti,

Aftësitë shtesë

- Entuziazëm dhe përkushtim personal në mënyrë që të jetë i dobishëm për institucionin,
- Plotësisht i besueshëm ndaj institucionit, objektivave dhe synimeve të stafit drejtues si
- Dhe personelit të Shkollës.

Paga: koef 4

Kontrata: Kohëzgjatja e periudhës provuese është gjashtë (6) muaj

Orari: 40 orë pune në javë

Procedurat e konkurrimit:

Afati i konkurrimit është 15ditë pas shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës në Ferizaj, Skenderaj.

